

ANKETIM ME QYTETARËT

BASHKITË E QARKUT TIRANË

TRANSPARENCA, QEVERISJA QYTETARE DHE LLOGARIDHËNIA



**Ky projekt u mbështet nga LevizAlbania
Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.**



Ky raport u realizua në kuadër të projektit

“BASHKITË E QARKUT TIRANË: TRANSPARENCA, QEVERISJA QYTETARE DHE LLOGARIDHËNIA”.

Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit, LevizAlbania.

EKIPI REALIZUES

Prof. Afrim Krasniqi
Dr. Dorina Berdufi

Ndihmuan

Rudina Niklekaj
Juliana Bilbilaj
Laurent Ymet
Alban Hoxha
Elsa Kepi
Arben Meta

INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: www.isp.com.al

Email: contactaips@isp.com.al dhe contactaips@gmail.com

Facebook: [Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies](#)

Adresa: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

PASQYRË E LËNDËS

1. PARATHËNIE

2. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

- 2.1. LIDHUR ME SISTEMIN E TRANSPARENCËS NË BASHKI
- 2.2. LIDHUR ME VLERËSIMIN E BILANCIT TË KËSHILLIT BASHKIAK DHE BASHKIVE
- 2.3. LIDHUR ME IMPAKTIN E REFORMËS SË RE TERRITORIALE
- 2.4. LIDHUR ME MANDATIN E ARDHSHËM TË QEVERISJES VENDORE

3. HYRJE

4. STANDARDET E TRANSPARENCËS DHE TË INFORMIMIT

- 4.1. CILAT JANË FORMAT MË TË PREFERUARA TË KOMUNIKIMIT?
- 4.2. SA % E KËRKESAVE QYTETARE TRAJTOHEN PLOTËSISHT NGA BASHKITË?
- 4.3. SA PROBLEMATIKA QYTETARË JANË NGRITUR NË KËSHILLIN BASHKIAK?
- 4.4. CILAT JANË PROBLEMATIKAT PRIORITARE TË TRAJTUARA NË KËSHILA?
- 4.5. KONFLIKTI I INTERESIT NË KËSHILLIN BASHKIAK?
- 4.6. SA % E QYTETARËVE NUK KANË INFORMACION MBI BUXHETIN LOKAL?
- 4.7. SA TRANSPARENTE JANË BASHKITË NË AKTIVITETIN / VENDIMMARRJEN E TYRE?
- 4.8. SA ËSHTË HAPËSIRA E QYTETARËVE PËR MONITORIM TË BASHKISË?
- 4.9. CILAT JANË FORMAT E NJOFTIMIT TË QYTETARËVE?
- 4.10. SA APLIKOHEN KËRKESAT ADRESUAR KËSHILLIT BASHKIAK?

5. KONSULTIMI DHE MIRËQEVERISJA LOKALE

- 5.1. SA EFEKTIVE JANË KONSULTIMET E BASHKISË/KËSHILLIT?
- 5.2. CILAT JANË FORMAT / VENDET E PREFERUARA PËR TAKIME NGA QYTETARËT?
- 5.3. SA NJIHEN KËSHILLTARËT LOKALË NGA QYTETARËT?
- 5.4. SA NJIHEN KËSHILLTARËT QË JANË BANORË NË ZONËN E TË ANKETUARIT?
- 5.5. SA % E QYTETARËVE NUK JANË FTUAR NË ASNJË KONSULTIM LOKAL?
- 5.6. SA ËSHTË BESIMI QYTETAR TEK TË ZGJEDHURIT LOKALË?
- 5.7. SA ËSHTË BESIMI QYTETAR TEK KËSHILLTARËT BASHKIAKË?
- 5.8. SA ËSHTË BESIMI QYTETAR TEK KRYETARI I BASHKISË?
- 5.9. SA ËSHTË BESIMI QYTETAR TEK KRYETARI I QARKUT?
- 5.10. SA ËSHTË BESIMI QYTETAR TEK PREFEKTI?
- 5.11. SA ËSHTË BESIMI QYTETAR TEK ADMINISTRATORËT LOKALË?
- 5.12. CILA ËSHTË SHPESHTËSIA E TAKIMIT ME INSTITUCIONET VENDORE?
- 5.13. CILI ËSHTË RAPORTI I KËSHILLTARËVE MIDIS INTERESAVE PERSONALE DHE INTERESAVE QYTETARE?
- 5.14. SA APLIKOHET PËRFSHIRJA QYTETARE NË VENDIMMARRJET LOKALE?
- 5.15. SA JANË MBAJTUR PREMTIMET NGA BASHKIA?
- 5.16. MATJA E PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMEVE BASHKIAKE
- 5.17. VLERËSIMI MBI CILËSINË E JETËS PAS MANDATIT TË PARË
- 5.18. BILANCI I EFIKASITETIT TË PUNËS SË BASHKISË
- 5.19. BILANCI I REFORMËS DHE SHËRBIMET PUBLIKE
- 5.20. AKSESI PËR TË ADRESUAR ANKESA / KËRKESA
- 5.21. PUSHTETI VENDOR VS PUSHTETI QENDROR: CILI KA MË SHUMË KOMPETENCA?
- 5.22. USHTRIMI I PUSHTETIT DHE PRITSHMËRIA PËR TË ARDHMEN

5.23. KËRKESAT PRIORITARE TË QYTETARËVE PËR VITIN 2019

6. BILANCI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE KRYESORE TË BASHKISË

- 6.1. VLERËSIMI MBI SHËRBIMIN E PASTRIMIT OFRUAR NGA BASHKITË
- 6.2. VLERËSIMI MBI SHËRBIMET NË SISTEMIN PARASHKOLLOR OFRUAR NGA BASHKITË
- 6.3. VLERËSIMI MBI SHËRBIMIN VADITJE DHE KULLIM OFRUAR NGA BASHKITË
- 6.4. VLERËSIMI MBI SHËRBIMIN NË TREGJE DHE ZHVILLIM OFRUAR NGA BASHKITË
- 6.5. VLERËSIMI MBI SHËRBIMIN UJËSJELLËS E KANALIZIME OFRUAR NGA BASHKITË
- 6.6. VLERËSIMI MBI SHËRBIMIN GJELBËRIM DHE NDRIÇIM OFRUAR NGA BASHKITË
- 6.7. VLERËSIMI MBI SHËRBIMIN RRUGË DHE TROTUARE OFRUAR NGA BASHKITË

7. VLERËSIMI MBI KËSHILLTARËT DHE KAPACITETET PËRFAQËSUESE TË TYRE

- 7.1. RËNDËSIA E KONTAKTIT ME QYTETARËT
- 7.2. BILANCI I NISMAVE PËR PROBLEMATIKAT QYTETARE
- 7.3. VLERËSIMI PËR NIVELIN E PËRGATITJES SË KËSHILLTARËVE
- 7.4. BILANCI I MBAJTJES SË PREMTIMEVE ELEKTORALE
- 7.5. QËNDRIMI BESNIK NDAJ PARTISË VS BESNIKËRIA NDAJ QYTETARËVE

8. PERCEPTIME QYTETARE PARA-ZGJEDHORE 2019

- 8.1. SISTEMI ELEKTORAL PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLTARËVE
 - 8.2. PREMTIMET PERSONALE TË KËSHILLTARËVE NDAJ KËSHILLTARËVE
 - 8.3. PREMTIMET PERSONALE TË KËSHILLTARËVE NDAJ KËSHILLTARËVE
 - 8.4. VLERËSIMI I PAMUNDUR PËR 3 KËSHILLTARË POZITIVË / NEGATIVË
-

1. PARATHËNIE

Reforma e re territoriale 2014) e shoqëruar me zgjedhjet e para lokale me ndarjen e re (2015) i kanë dhënë jetë një sistemi të ri të qeverisjes lokale në Shqipëri. Sistemi me 61 bashki disproporcionale në sipërfaqe dhe numër banorësh u shoqërua me zgjedhjet në sistemin mazhoritar për kryetarët e bashkive dhe në sistemin proporcional me listë të mbyllur për këshilltarët bashkiakë. Vendin e ish kryetarëve të komunave të shkrira në ndarjen e re e zunë administratorët e njësive, të emëruar nga kryetari i bashkisë.

Reforma e re u jetua në të njëjtën kohë me hyrjen në fuqi edhe të ligjit 119/2015 “Për të drejtën e informimit”, të ligjit 146/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin Publik” si dhe të ligjit organik 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Secili prej këtyre ligjeve ofroi mekanizma të rinj ligjorë dhe administrativë në funksion edhe të rritjes së transparencës, pjesëmarrjes qytetare dhe llogaridhënies nga organet e zgjedhura ose të emëruara vendore.

Në përfundim të vitit të tretë të mandatit të parë të qeverisjes vendore në qarkun Tiranë, Instituti i Studimeve Politike, me mbështetjen e Lëviz Albania, ka iniciuar projektin “Bashkitë e qarkut tiranë: transparenca, qeverisja qytetare dhe llogaridhënia”. Pjesë e rëndësishme e këtij projekti ishte edhe nevoja e matjes së perceptimit publik në nivel qarku dhe paralelisht edhe në nivel bashkish, mbi problematikat lokale, standardet e transparencës dhe llogaridhënies, për praktikatat e konsultimit publik dhe mbi të gjitha, për perceptimin e qytetarëve mbi efektivitetin e qeverisje lokale në këto elementë thelbësorë të qeverisjes demokratike.

Të dhënat e këtij anketimi vetëm sa konfirmojnë gjetje dhe problematika të konstatuara edhe në forma të tjera të matjes (takime, intervista, fokus grupe, etj) në bashkitë e qarkut Tiranë. Vlera e tyre kryesore është se janë të dhëna të detajuara në një numër të madh çështjesh dhe këndvështrimesh, duke na ofruar perceptime përfaqësuese në vlerësimin e bilancit të punës nga bashkitë dhe këshillat bashkiakë, nga organet e zgjedhura dhe të emëruara, nga puna e secilit këshilltar dhe specifikat e secilës bashki. Perceptimet arrijnë të krijojnë një imazh real të marrëdhënieve qytetare me pushtetin vendor gjatë këtij mandati qeverisës, të problematikave në ushtrimin e funksioneve bazës në shërbim të qytetarëve, të raporteve midis pushtetit qendror dhe pushtetit lokal në funksion të shërbimit ndaj qytetarëve, etj.

Gjetjet kanë vlerë sidomos për të ndihmuar strukturat e sotme lokale në përmirësimin e punës së tyre, për partitë politike dhe kandidatët që konkurrojnë në zgjedhjet e ardhshme lokale 2019, si dhe për orientimin në hartimin e platformave dhe programeve elektorale të subjekteve konkurruese. Gjetjet kanë vlerë edhe për të matur bilancin e punës së bashkive dhe për të nxjerrë në pah segmentet funksionale dhe jo funksionale të tyre, si dhe për të orientuar debatin edhe në nevojën e rishikimit të sistemit të zgjedhjeve lokale, për këshilltarë që përfaqësojnë shumë më tepër vullnetin qytetar sesa vullnetin e partive politike.

Instituti i Studimeve Politike (ISP) do të vijojë edhe më tej të ketë fokus të kërkimeve dhe aktiviteteve të tij standardet e mirëqeverisjes, të përfaqësimit, të legjitimitetit dhe të besueshmërisë publike.

2. PËRMBLEDHJE E GJETJEVE

Gjetjet kryesore janë renditur sipas problematikave dhe ndarjeve në anketim dhe janë të dhëna përfaqësuese për të kuptuar më mirë gjendjen aktuale të pushtetit vendor në qarkun Tiranë, nivelin e transparencës dhe të llogaridhënies, standardet e konsultimit publik dhe elementë të tjerë të përfshirë në fokusin e projektit të ISP dhe Lëviz Albania.

2.1. LIDHUR ME SISTEMIN E TRANSPARENCËS NË BASHKI

- 96% e qytetarëve deklarojnë se nuk kanë asnjë informacion specifik mbi sasinë e buxhetit vjetor të bashkisë ku ata banojnë dhe nuk kanë asnjë informacion nga vetë bashkia mbi buxhetin, pavarësisht detyrimit ligjor për konsultime dhe dëgjesa.
- Vetëm 23% e qytetarëve i vlerësojnë bashkitë si transparente, ndaj 48% që i vlerësojnë si jo transparente në vendimmarrjet dhe aktivitetin e tyre.
- Rreth një e treta e qytetarëve (29%) mendojnë se kërkesat e tyre nuk merren fare parasysh nga këshilli bashkiak dhe bashkia, dhe vetëm 5% mendojnë se kërkesat e tyre merren parasysh.
- Një e treta e qytetarëve nuk kanë informacion nëse ka pasur ndonjë investim të bashkisë në zonën ku ata banojnë, si dhe 40% e qytetarëve deklarojnë se nuk kanë asnjë mundësi monitorimi të projekteve në bashki
- Mbi 71% e qytetarëve nuk përdorin faqen online të bashkisë për informimin e tyre, 82% nuk aplikojnë informimin përmes telefonit në bashki dhe se 83% nuk informohen përmes komunikimit me kërkesa adresuar bashkisë ose këshilltarëve.
- Gjysma e qytetarëve nuk janë në dijeni se bashkitë kanë rregullore dhe akte të tjera rregullatore lidhur me ankesat e qytetarëve në bashki.
- Më shumë se 70% e qytetarëve preferojnë format tradicionale të komunikimit, adresim me shkrim të kërkesave të tyre në bashki. Në totalin e kërkesave me shkrim dominon bashkia Vorë me 27%, Kamëz me 22% dhe në fund është bashkia Tiranë urbane me 9%.

2.2. LIDHUR ME VLERËSIMIN E BILANCIT TË KËSHILLIT BASHKIAK DHE BASHKIVE

- 75% e qytetarëve nuk janë në dijeni nëse në mbledhjet e Këshillit Bashkiak 2015-2018 është ngritur ndonjë çështje që lidhet me problematikat e tyre prioritare, vetëm 22% shprehen se janë në dijeni.

- Pjesëmarrja qytetare në mbledhjet dhe konsultimet e organizuara nga Këshilli Bashkiak është në nivele minimale: në Tiranë, Kavajë e Kamëz është rreth 6%, në Rrogozhinë vetëm 1,7% dhe në Vorë 13%.
- Mbi 86% e qytetarëve nuk janë ftuar asnjëherë në konsultime nga bashkia dhe këshillat bashkiakë, mbi 3% janë ftuar vetëm 1 herë, mbi 2% vetëm 2 dhe 3 herë, mbi 1% mbi 4 deri 6 herë.
- 56% e qytetarëve nuk janë takuar asnjëherë me kryetarin e bashkisë, 69% asnjëherë me një këshilltar bashkiak, 89% asnjëherë me drejtuesin e qarkut dhe prefektin dhe rreth 60% asnjëherë me administratorin e njësisë.
- Rreth 35% e qytetarëve deklaruan se nuk kanë pasur asnjëherë një takim me ndonjë këshilltar bashkie; 75% dëshirojnë të zhvillojnë takime me këshilltarët në mjediset e bashkisë dhe vetëm 7% në zyrat e partive, 5% në kafe dhe 2% në terren.
- 50.8% e qytetarëve mendojnë se këshilltarët bashkiakë, në vend që të mendonin për interesat dhe nevojat e qytetarëve, mendonin e punonin për interesat e tyre personal.
- 65% e qytetarëve nuk njohin me emër asnjë prej anëtarëve të këshillit bashkiak ku ata jetojnë, vetëm 7.9% konfirmuan të paktë një emër këshilltari, 5.6% dy emra, 2.9% tre emra, dhe 0.4% një pjesë të madhe të këshillit bashkiak.
- 69% e qytetarëve nuk njohin asnjë këshilltar që banon në të njëjtën zonë/lagje me ta, 26% konfirmuan njohjen e ndonjë këshilltari që banon në zonën e tyre.
- 56% e qytetarëve kanë vlerësim negativ për bilancin e këshilltarëve në funksionin për marrjen e nismave të ndryshme ligjore që lidhen me qytetarët. 45% e qytetarëve vlerësojnë se nuk janë mbajtur premtimet e dhëna nga këshilltarët më 2015, shifer mbi 8 herë më e lartë sesa numri i atyre që kanë vlerësim pozitiv.

2.3. LIDHUR ME IMPAKTIN E REFORMËS SË RE TERRITORIALE

- Një e treta e qytetarëve vlerëson se edhe me reformën e re territoriale qytetarët nuk janë përfshirë më shumë në vendimmarrjen në qeverisjen qendrore, vetëm 19% janë vlerësues pozitivë.
- Vetëm 8% konfirmojnë se janë mbajtur premtimet e dhëna nga kryetari i bashkisë ose këshilltarët gjatë fushatës elektorale 2015, dhe më shumë se 36% kanë vlerësim tërësisht negativ për bilancin e mbajtjes së premtimeve.
- Rreth 45% e qytetarëve mendojnë se me reformën e re territoriale dhe qeverisjen aktuale vendore nuk është përmirësuar cilësia e shërbimeve bashkiake, 19% kanë vlerësim pozitiv për bilancin e ofrimit të shërbimeve.

- 55% e qytetarëve deklaruan se nuk shohin përmirësime pozitiv në tërësi jetën e tyre pas aplikimit të reformës së re territoriale, 21% deklaruan përmirësime të dukshme pozitive.
- Mbi 51% e qytetarëve ishin kritikë në vlerësimet nëse ndarja e re territoriale e ka përmirësuar efikasitetin e punës së bashkive në shërbimet e tyre nda qytetarëve, dhe vetëm 17% ishin vlerësues pozitiv.
- Më shumë se gjysma e banorëve vlerësojnë se ndarja e re territoriale ua ka lehtësuar mënyrën e kërkimit të informacionit në bashki dhe institucione lokale.
- Vetëm 28% e qytetarëve e vlerësojnë pozitivisht shërbimin e pastrimit të territorit dhe mjediseve publike, si kompetencë e zgjeruar me ndarjen e re territoriale.
- Shumica e qytetarëve vlerësojnë pozitivisht punën e pushtetit vendor në ushtrimin e funksioneve të saj në edukimin parashkollor.
- Katër në pesë qytetarë janë kritikë në vlerësimin e ushtrimit të funksionit të vaditjes dhe të kullimit si dhe funksionin në administrimin e tregjeve dhe zhvillimin social – ekonomik nga ana e bashkive të reja të qarkut.
- Një në dy qytetarë kanë mendim dukshëm negativ mbi bilancin në ushtrimin e funksionit të bashkisë në shërbimet e ujësjellësit dhe të kanalizimeve. Vetëm një në tre qytetarë ka vlerësim pozitiv. Pothuajse gjysma e qytetarëve ndajnë vlerësim pozitiv apo negativ në vlerësimin e bilancit të punës së bashkive në shërbimet e gjelbërimit dhe të ndriçimit, si dhe në shërbimet e mirëmbajtjes së rrugëve dhe të trotuareve.

2.4. LIDHUR ME MANDATIN E ARDHSHËM TË QEVERISJES VENDORE


- 87% e qytetarëve kërkojnë të ndryshojë sistemi zgjedhor më 2019 dhe që këshilltarët të zgjidhen nga qytetarët duke hequr sistemin me lista të mbyllura. Mbështetës të sistemit aktual ishin vetëm 5%.
- 51% e qytetarëve u deklaruan kundër rizgjedhjes së anëtarëve aktualë të Këshillit Bashkiak ndaj 25% mbështetëse për rizgjedhje e tyre.
- Gjysma e qytetarëve mendojnë se pushteti lokal duhet të ketë shumë më tepër kompetenca sesa pushteti qendror në shërbimet kryesore ndaj qytetarëve. 76% e qytetarëve mendojnë se në të ardhmen pushteti vendor duhet të ketë më shumë kompetenca mbi administrimin lokal sesa ai qendror.
- Tri problematikat që kërkojnë trajtim prioritare më 2019 për qytetarët e qarkut Tiranë janë: rrugët, punësimi dhe furnizimi me ujë. Për bashkinë Tiranë prioritet janë papunësia, rrugët rurale dhe infrastruktura; për bashkinë Kavajë janë rrugët, furnizimi me ujë dhe pastrimi; për bashkinë Kamëz janë furnizimi me ujë, rrugët dhe kanalizimet; për bashkinë Rrogozhinë problematikat kryesore janë rrugët, papunësia dhe infrastruktura, kurse për bashkinë Vorë janë ujësjellësi, rrugët dhe gjendja e shkollave.

3. HYRJE

Ky pyetësor zhvillohet në kuadër të projektit “Bashkitë e qarkut tiranë: transparenca, qeverisja qytetare dhe llogaridhënia” që ISP po zhvillon me mbështetjen e Lëviz Albania. Në fazat e para të projektit stafi i ISP ka kontaktuar me pesë bashkitë e qarkut Tiranë, ka testuar aplikimin e sistemit të informimit përmes praktikave ligjore me ligjin mbi të drejtën e informimit, ka monitoruar nivelin e aktivizimit të këshilltarëve në mediat e ndryshme dhe në aktivitete publike, si dhe ka zhvilluar fokus grupe debati në secilën prej pesë bashkive.

Qëllimi i anketimit është njohja nga afër e perceptimit qytetar mbi qeverisjen vendore në bashkinë e tyre, vlerësimet për këshilltarët dhe organet vendimmarrëse, raportet midis organeve të zgjedhur lokale dhe qytetareve, cilësinë e funksionimit të sistemit të komunikimit, të transparencës dhe të llogaridhënies, etj. Anketimi synon edhe të analizojë përmbushjen e detyrimeve të qeverisjes vendore, nivelin, cilësinë e ofrimit të shërbimeve, funksioneve bazë të bashkisë dhe suksesin e qeverisjes vendore.

Ekspertët e ISP programuan zhvillimin e anketimit në pesë bashkitë, përkatësisht në Tiranë 1200 anketime (duke ndarë në raportet 2 x 1 Tiranën urbane me Tiranën rurale), Kamza 800, Kavaja 600 dhe Vora e Rrogozhina nga 500 anketa. Realizimi i anketimit u bë në muajin tetor 2018 dhe përgjigjet e tyre ishin anonime. Personat e përfshirë në realizimin e anketave ishin të rinj ish studentë dhe studentë kryesisht të shkencave sociale, politike, medias dhe të marrëdhënieve publike, - me përvojë në projekte të njëjta me ISP dhe organizata të tjera edhe në të kaluarën. Ekipet e të rinjve u shpërndanë nëpër bashki sipas një plani të detajuar duke synuar të realizohet kampionimi sa më real tek të gjitha grupet, moshat, zonat dhe shtresat e banorëve të bashkive.





Mosha e personave të përfshirë në pyetësor është mbi 19 vjeç. Mosha 18 vjeçare është lënë jashtë pyetësorit për shkak se ka pasur moshë të hershme në periudhën kur janë zhvilluar zgjedhjet e fundit lokale në vend (2015). Marzhi i gabimit është llogaritur +/-2.6. Stafi është përkujdesur për të bërë balancim sa më të madh gjinor në anketim, për të pasur përfaqësim horizontal të të gjitha shtresave të popullsisë dhe zonave të bashkive të qarkut Tiranë dhe për të përfshirë në testim problematikat e aspektet thelbësore në raportet midis të zgjedhurve dhe zgjedhësve. Të gjitha pyetjet janë analizuar në dy nivele: në nivel qarku dhe në nivel krahasimor për secilën bashki.

Pyetësori përbëhet nga 2 module kryesore: a) Transparenca dhe informimi, si dhe 2) Konsultimi dhe mirëqeverisja lokale. Brenda tyre ka nën-ndarje që lidhen me kompetenca, përgjegjësi, forma komunikimi dhe perceptime mbi shërbimet dhe bilanin e punës, si dhe prognoza/këshilla për të


ardhmen. Referuar përqindjes së pyetësorëve të zhvilluar, rezultojnë se numri më i lartë i pyetësorëve ka qenë në zonën e Tiranës urbane 22.9%, ndjekur nga Kamza me 21.9%, Kavaja 17%, Vora e Rrogozhina me nga 14%, si dhe Tirana rurale me 10%.

Vendimi për të ndarë në kategori të veçanta Tiranën (zona rurale dhe urbane) lidhet kryesisht me nevojën për të shpjeguar më mirë në formë të krahasuar tendencat dhe perceptimet e qytetarëve, si dhe ngjashmërive të shumta që ka Tirana rurale me shumicën e bashkive të tjera, ndërkohë që problematikat e Tiranës urbane dhe rurale kanë dallime të shumta. Vlerësimi i ndarë vlen edhe për të kuptuar më mirë efektet e reformës territoriale dhe bilancin e qeverisjes së re lokale në bashkinë më të madhe në vend. Në tabelën e gjinisë rezultojnë se pjesa më e madhe e banorëve janë të gjinisë mashkullore (53%) ndaj asaj femërore (47%). Arsyet e disbalancës janë kryesisht për shkak të vështirësive të hasura në zona të ndryshme rurale për respektimin e gjinisë në anketim.



Referuar moshës së të anketuarve, kategoria më e madhe i përket moshës 26-35 vjeç, (24%), kurse kategoritë e tjera të moshave janë në proporcion nga 18% deri 20%, me përjashtim kategorinë e moshës 19-25 vjeç, e cila përfaqësohet me 16%.


Arsyeja e disbalancës për këtë moshë lidhet kryesisht me faktin se 18 vjeçarët që kanë votuar më 2015 tanimë janë 21 vjeç, ndaj mund të krijonte problematika tërheqja e më shumë opinioneve nga të rinjtë që nuk kanë qenë votues më 2015. Me siguri që në pjesën e atyre që nuk kanë dhënë përgjigje ose që kanë pasur pamundësi të shprehin një qëndrim në shumë pyetje, mund të ketë individë që nuk kanë votuar më 2015 ose që janë nën moshën 21 vjeç aktualisht, megjithatë si banorë dhe taksapagues edhe ata kanë të drejtat e tyre në ushtrimin e llogaridhënies ndaj pushtetit vendor dhe vlerësimit të bilancit të punës së bashkisë / këshilltarëve.




Lidhur me zonat e banimit të qytetarëve të përfshirë në anketim, pjesa më e madhe i përket zonës rurale, edhe për shkak se sipërfaqja rurale në pesë bashkitë është 2% më e madhe, dhe se problematikat rurale janë shumë më të identifikueshme sesa problematikat shpesh kolektive në zonat urbane.

Në përgjigjet e dhëna nga qytetarët ka pasur vështirësi identifikimi midis zonave urbane dhe rurale, por parimi i ndarjes në grupet e anketimit është bazuar kryesisht në mënyrën e organizimit të njësive administrative përpara vitit 2015, duke përfshirë bashkitë në zona urbane dhe ish komunat në zonat rurale. Lidhur me nivelin e edukimit shkollor/universitar të qytetarëve të përfshirë në anketim, rezultojnë se pjesa më e madhe janë me arsim të mesëm të përfunduar (40%), ndjekur nga personat që kanë përfunduar një universitet në periudha të ndryshme (18%), si dhe kategoria e tretë, personat që kanë përfunduar arsimin fillor por nuk kanë vijuar më tej shkollën (10%).

NIVELI MË I LARTË I EDUKIMIT




STATUSI CIVIL



Kategori pa dëshmi edukimi shkollor është 0.8%, kurse kategoria me titull doktoral është 0.1%, kategoria me master është 4.2%, kurse kategoria me të mesme të papërfunduar është rreth 7%. Lidhur me statusin civil të personave të përfshirë në pyetësor rezultojnë se 65% janë në marrëdhënie martesore, 25% janë beqar dhe pjesa tjetër e divorcuar ose pa përgjigje specifike. Qytetarët u pyetën edhe për të ardhurat e tyre mujore. Përgjigjet e dhëna ishin të ndryshme, por merr vëmendje përgjigjia se rreth 21% e qytetarëve kanë të ardhura të rregullta minimale (ndihma sociale ose pagesa të parregullta në punë informale dhe burime të tjera). Kategoria mbi 1 milion lekë është vetëm 2.5% e të pyeturve, kategoria midis 30 mijë lekë dhe 50 mijë lekë përbën edhe pjesën më të madhe, rreth 34% e të pyeturve.

TË ARDHURAT FINANCIARE MUJORE




4. STANDARDET E TRANSPARENCËS DHE TË INFORMIMIT

Sipas ligjit, të gjitha bashkitë duhet të kenë Rregullore që përcakton procedurat dhe praktikat e komunikimit të qytetarëve me institucionin. Përmes Rregullores përcaktohen mënyrat e ankimimit, forma, formati, afati kohor, kontakti dhe elementë të tjerë teknikë që mundësojnë një proces transparent komunikimi midis qytetarit e Bashkisë. Praktika të tilla janë standarde minimale bashkëkohore dhe se institucionet, përveç detyrimit për të pasur Rregullore, kanë edhe detyrimin për të informuar publikun mbi praktikat e procedurat e komunikimit.

Të dhënat e anketimit tregojnë mospërputhje midis këtij parimi ligjor dhe gjendjes faktike. Konkretisht, numri i qytetarëve të anketuar që nuk janë në dijeni se bashkia ku ata banojnë ka ndonjë Rregullore për dërgimin e ankesave është rreth 1% më i madh sesa numri i atyre që pohojnë ekzistencën e një dokumenti të tillë. Qytetarët që pohojnë dijeninë mbi Rregulloren në bashki për ankesat zënë 48,8% të të anketuarve, nga 49,6% që shprehen se nuk janë në dijeni për ekzistencën e një dokumenti dhe praktike të tillë.


A JENI JU SI QYTETAR I BASHKISË NË DIJENI QË KA NJË RREGULLORE PËR DËRGIMIN E ANKESAVE TUAJA NË BASHKI?



4.1. CILAT JANË FORMAT MË TË PREFERUARA TË KOMUNIKIMIT?


Në komunikimin e qytetarëve me institucionet vend dominues zë komunikimi tradicional me kërkesë me shkrim, në dallim nga format e reja të komunikimit elektronik dhe me email. Të pyetur nëse kanë bërë ndonjëherë kërkesë me email ose me shkrim në bashki ose në institucionet e saj të varësisë, qytetarët vlerësojnë se 15% kanë bërë kërkesa me shkrim dhe 3% me email, ndaj përkatësisht 79% dhe 57% që konfirmojnë se nuk kanë bërë kërkesë me shkrim ose me email. Kategoria e personave që nuk janë në gjendje të japin një përgjigje (për arsye nga më të ndryshmet, si p.sh. nuk mbajnë mend, ose nuk i kuptojnë fare këto forma komunikimi) është shumë e lartë, sidomos në alternativën e komunikimit me email (40%). Të pyetur vetëm ata që kanë bërë kërkesa nëse kanë marrë përgjigjen e duhur nga institucioni, vetëm 9,9% përgjigjen pozitivisht, 24% përgjigjen negativisht dhe pjesa tjetër përgjigjen në trajta të ndërmjetme ose refuzojnë të japin një përgjigje të prerë.

A KENI BËRË JU NDOJËHERË KËRKESA ADRESUAR BASHKISË PËR NJË PROBLEMATIKË?



Të ndarë sipas bashkive rezultojn se banorët që kanë numrin më të lartë të kërkesave me shkrim adresuar pikave të kontaktit në faqen zyrtare të bashkisë janë qytetarët e Vorës me 27%, ndjekur nga qytetarët e Kamzës me 22%, ata të Kavajës e Rrogozhinës me nga 10% dhe në fund qytetarët e qytetit Tiranë me 9%. Në alternativën e kërkesave me e-mail në adresat e faqes zyrtare të bashkisë, numri i personave është shumë më i vogël, - nga 0.8% në Rrogozhinë, 1.7% në Kavajë e T-RURALE e Tiranës, në 3,6% në qytetin Tiranë, 4% në Kamëz dhe 5,4% në bashkinë Vorë.

Bashkia Tiranë aplikon edhe aplikacionin “Tirana ime”, ku kryesisht bëhen denoncime ose adresohen problematika të ndryshme nga qytetarët. Nga monitorimi që ne i kemi bërë këtij portali për një periudhë dy mujore (shtator-tetor 2018) ne rezultoi se numri i kërkesave ishte minimale dhe më vetëm portali nuk ishte i përditësuar me të dhëna. Nga monitorimi i pjesshëm që kemi bërë më vonë (janar 2019) na rezultoi se portali ka pasur më shumë raste denoncimesh dhe kërkesash, por ende nuk ka një mekanizëm transparent matës të numrit real dhe efikasitetit real të portalit.




4.2. SA % E KËRKESAVE QYTETARE TRAJTOHEN PLOTËSISHT NGA BASHKITË?

Qytetarët u pyetën nëse kërkesat dhe problematikat e tyre merren në konsideratë nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak në pesë bashkitë. Nga përfundimet në rang qarku, rezultoi se më shumë se 54% e kërkesave dhe problematikave nuk merren fare parasysh ose merren shumë pak, - shifër shumë e lartë dhe tregues kritik për raportet midis qeverisë lokale dhe raporteve të tyre me qytetarët.

Në total 29% nuk merren fare parasysh, 25% merren shumë pak parasysh, 23% merren vetëm pjesërisht parasysh dhe vetëm 12% rezultojnë se merren seriozisht parasysh. Numri i kërkesave dhe problematikave që merren plotësisht parasysh sipas perceptimit qytetar është vetëm 5%.

SA MENDONI QË KËRKESAT DHE PROBLEMATIKAT E QYTETARËVE MERREN PARASYSH PËR TU DISKUTUAR NË MBLEDHJET E KËSHILLIT BASHKIAK?



Të dhënat u analizuan edhe specifikisht në secilën bashki. Nga krahasimi tyre rezulton se mbi bashkia Vorë ka përqindjen më pozitive, me vetëm 30% vlerësim negativ se asnjë kërkesë nuk është marrë parasysh ose është marrë shumë pak parasysh. Dy kategoritë në bashkitë e tjera rezultojnë rreth 64% në Kavajë, 64% në zonat rurale të Tiranës, 61% në Rrogozhinë, 67% në Kamëz dhe 51% në Tiranë.

Në vlerësimin pozitiv (të gjitha merren parasysh ose shumica merren parasysh) përqindjen më pozitive e ka Vora me 25%, ndjekur nga Tirana me 17%, Rrogozhina me 13%, ndjekur nga Kavaja me rreth 12%, T-RURALE e Tiranës me rreth 10% dhe Kamza me vetëm 7%.

SA MENDONI QË KËRKESAT DHE PROBLEMATIKAT E QYTETARËVE MERREN PARASYSH PËR TU DISKUTUAR NË MBLEDHJET E KËSHILLIT BASHKIAK?

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Të gjitha merren parasysh	4,5%	5%	3,4%	4,2%	2%	10,9%
Shumica merren parasysh	13,6%	6,7%	6,7%	9,2%	5%	25,9%
Disa merren parasysh	27,3%	22,4%	20,2%	16%	19%	31,3%
Pak merren parasysh	30,9%	26,7%	24,4%	21%	30%	15%
Asnjë nuk merret parasysh	20,9%	37,5%	39,5%	40,3%	37%	14,3%
Pa përgjigje	2,7%	1,7%	5,9%	9,2%	7%	2,7%


4.3. SA PROBLEMATIKA QYTETARË JANË NGRITUR NË KËSHILLIN BASHKIAK?

Qytetarët u pyetën nëse janë në dijeni se ndonjë nga problematikat e zonës ku ata banojnë është trajtuar në mbledhjet e Këshillit Bashkiak gjatë këtij mandati. Më shumë se dy të tretat e qytetarëve përgjigjen se nuk janë në dijeni (75%), dhe vetëm 22% konfirmojnë se janë në dijeni.

Distanca e madhe midis personave që nuk janë në dijeni dhe atyre që janë në dijeni është tregues i mungesës së informacionit dhe pafuqisë së vetë Këshillave Bashkiakë për të pasqyruar punën dhe

aktivitetin e tyre. Gjatë këtij mandati, si edhe në mandatet e tjera, Këshillat Bashkiakë kanë trajtuar çështje të ndryshme lokale, përfshirë ndihmat sociale, banesat sociale, planet rregulluese, investimet lokale, etj, të cilat prekin të gjitha komunitetet dhe janë përherë pjesë e kërkesave dhe problematikave që ngrënë qytetarët pavarësisht zonës ku ata banojnë në territorin e bashkisë.

A JENI JU NË DIJENI TË NDONJË PROBLEMATIKE TË ZONËS TUAJ QË ËSHTË NGRITUR NË MBLEDHJET BASHKIAKE?



Duke e specifikuar përgjigjen sipas bashkive dhe zonave ku është zhvilluar sondazhi, rezultojnë se përqindjen më të lartë të përgjigjeve negative (që nuk janë në dijeni të ndonjë rasti kur Këshilli Bashkiak ka trajtuar problematika të zonës ku ata banojnë) ë zënë Kavaja e Tirana, me përkatësisht 82% dhe 80%. Kjo përqindje e lartë në dy prej bashkive më të vjetra dhe më me shumë kapacitete përfaqësimi dhe transparence, mund të ketë shpjegime të ndryshme që nga mungesa e informacionit, kompleksiteti në përfaqësim dhe deri tek natyra e centralizuar e problematikave prioritare. Në çdo rast, gjykimi i ardhur nga anketimet tregon se ka diferencë midis perceptimit të vetë bashkive dhe perceptimit qytetar mbi trajtimin e problematikave lokale. Në Tiranë vetëm 15% konfirmojnë trajtimin e problematikave të tyre lokale në Këshillin Bashkiak, rreth 7% më pak sesa mesatarja në rang qarku. Në Kavajë shifra është më e ulët, vetëm 12%. Qytetarët më “të përfaqësuar” dhe që konfirmojnë përfshirjen e problematikave të tyre në mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë qytetarët e Vorës me 35%, ndjekur nga Rrogozhina me 29%, periferia e qytetit Tiranë më 22% dhe në fund Kamza me 18%.

A JENI JU NË DIJENI TË NDONJË PROBLEMATIKE TË ZONËS TUAJ QË ËSHTË NGRITUR NË MBLEDHJET BASHKIAKE?

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Po	15,9%	12,5%	22,7%	29,4%	18%	35,4%
Jo	80,9%	82,5%	75,6%	61,3%	81%	63,9%
Pa përgjigje	3,2%	5%	1,7%	9,2%	1%	0,7%

4.4. CILAT JANË PROBLEMATIKAT PRIORITARE TË TRAJTUARA NË KËSHILA?

Qytetarët që kanë konfirmuar se problematikave të tyre lokale janë trajtuar në mbledhjet e Këshillave Bashkiakë, janë pyetur edhe me problematikave konkrete, cilat kanë qenë ato. Në përgjigjet e tyre vend

kryesor zënë problematikat që lidhen me rrugët dhe infrastrukturën rrugore (mbi 4%), ndjekur nga ujësjellësi dhe shërbimet sociale (1-2%), problematika me mbeturinat (1%), transporti lokal, linjat urbane (1%), etj.

Në listën e dhënë nga qytetarët bëjnë pjesë 89 problematika specifike lokale, - një tregues se problematikat prioritare lokale ndryshojnë nga zona në zonë në të njëjtën bashki dhe në vetë bashkitë e të njëjtit qark. Tema të tjera të preferuara për qytetarët janë nga tabelat e qarkullimit dhe problemet e trafikut, nga funksionimi i administratorëve dhe problematikave specifike që lidhen me pallatet e banimit, me konviktet dhe kushtet e shkollave, si dhe me problematikat e pastrimit të ambientit dhe trajtimin e mbeturinave. Secila nga këto kategori është konfirmuar në më shumë se 0,8% të të anketuarve.


Duke i ndarë problematikat sipas bashkive, rezulton se në bashki si Kavaja, problematikat kryesore të trajtuara janë problemet e dhënies së tokës me koncesion, furnizimi me energji elektronike, kanalizimet, mbyllja e stacionit televiziv lokal, trajtimi i mbeturinave, etj.

- Në Tiranë problematikat kryesore lidhen me rrugët, me ujësjellësin, me përpunimin e mbeturinave dhe problematika të ndryshme të infrastrukturës dhe të gjelbërimit.
- Në zonën e rurale të Tiranës problematikat kryesore lidhen me çështjen e pronave, infrastruktura, kanalizimet, kangjellat dhe linjat urbane.
- Në bashkinë Rrogozhinë problematikat kryesore sipas qytetarëve lidhen me rrugën e varrezave, energjinë ndriçimin dhe shkollat në rikonstruksion, me infrastrukturën dhe kioskat në zonat e plazhit, me zonën e përpunimit të mbeturinave, mbikalimet dhe ndihmën ekonomike.
- Në bashkinë Kamëz problematikat kryesore lidhen me kanalizimet dhe gjelbërimitin e rrugëve dhe mjediseve publike, me infrastrukturën, me ndihmën sociale dhe strehimin.
- Në Bashkinë Vorë problematikat kryesore lidhen me rrugët dhe kanalizimet, ujësjellësin dhe kushtet e transportit publik.

4.5. KONFLIKTI I INTERESIT NË KËSHILLIN BASHKIAK?

Referuar mbledhjeve të Këshillit Bashkiak qytetarët u pyetën nëse kanë pasur informacion ose indicie të ndryshme për ndonjë rast të konfliktit personal të interesit në Këshillin bashkiak apo nga ana e drejtuesve të bashkisë në vendimet e marra në bashki.

Përgjigjia se 93% nuk dinë raste të konfliktit të interesit është pozitive, por mbetet perceptim përderisa në përgjigjet e tjera rezulton se qytetarët kanë pak informacione reale për përbërjen e Këshillit Bashkiak dhe për aktivitetin e tyre në Këshill.



Të ndarë sipas bashkive, rezulton se qytetarët e bashkisë Tiranë (qyteti) kanë nivelin më të lartë të konfirmimit të rasteve të konfliktit të interesit në vendimmarrjen e drejtuesve të bashkive dhe të

këshillit bashkiak, dhe se Tirana rurale ka përqindjen më të ulët. Konkretisht, në qytetin e Tiranës 88% mendojnë se nuk ka pasur raste të konfliktit të interesit, por 6,4% mendojnë se ka pasur raste të tilla. Përqindja e atyre që mendojnë se ka pasur raste të konfliktit të interesit në Vorë është 6,1%, në Rrogozhinë 5%, në Kavajë 4,2% dhe në Kamëz 3%. Në zonat rurale të Tiranës nuk ka pasur raste të konfirmimit të konfliktit të interesit.

A JENI NË DIJENI TË NDOJË RASTI TË KONFLIKTIT PERSONAL TË KËSHILLIT BASHKIAK APO DREJTUESVE TË BASHKISË NË VENDIMET E MARRA NË BASHKI?


PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Po	6,4%	4,2%	0	5%	3%	6,1%
Jo	88,6%	95,8%	100%	89,1%	96%	93,9%
Pa përgjigje	5%	0%	0	5,9%	1%	0

Qytetarët, të cilët deklaruan se janë në dijeni të rasteve të konfliktit të interesit u pyetën më tej rreth temave dhe çështjeve konkrete, të cilat ata i mendojnë si vendimmarrje në konflikt interesi. Në përgjigjet e tyre tematika kryesore lidhej me vendimmarrjet nga zyrtarët që lidhen me funksionet e tyre miratuese, me çështjen e Teatrit Kombëtar, me problematikat në rritjen e çmimit të biletave për shërbimin urban, me ndarjen e bursave dhe të buxhetit, si dhe sektori i pastrimit dhe i administrimit të territorit.


4.6. SA % E QYTETARËVE NUK KANË INFORMACION MBI BUXHETIN LOKAL?

Bashkitë kanë detyrimin ligjor të organizojnë konsultime publike mbi buxhetin dhe zbatimin e tij, por të dhënat e mbledhura nga perceptimi i qytetarëve lidhur me nivelin e informacionit që kanë mbi buxhetin tregojnë se ata janë të painformuar. Në total në nivel qarku, 96% e qytetarëve deklarojnë se nuk kanë asnjë informacion specifik mbi sasinë e buxhetit vjetor të bashkisë ku ata banojnë dhe nuk kanë asnjë informacion nga vetë bashkia mbi buxhetin.

A KENI DIJENI SA ËSHTË BUXHETI VJETOR I BASHKISË SUAJ? A JU KANË INFORMUAR PËR KËTË?



Duke analizuar secilën bashki më vete, rezulton se secila nga pesë bashkitë e qarkut Tiranë ka tregues prej 93% deri 98% të qytetarëve të përfunduar mbi buxhetin. Në Vorë situata rezulton më pozitive, me rreth 6% të qytetarëve të informuar, ndjekur nga Rrogozhina me 3,4% dhe Tirana me 2,7%, kurse në zonat rurale të Tiranës rezultatet janë shumë më kritike sesa në secilën zonë tjetër të qarkut Tiranë, me vetëm 0.8% të qytetarëve të informuar.



Qytetarët që kanë konfirmuar se janë informuar mbi buxhetin janë pyetur konkretisht, mbi të dhëna të buxhetit për investimet dhe për shërbimet. Nga përgjigjet citohen shifra nga më të ndryshmet, p.sh, 30% e buxhetit (20% nga ata që kishin informacion), 6 milionë (10%), 7 miliardë (10%), 70% ose 95% (nga 10% e atyre që deklarorin se kishin informacion), - secila përgjigje pa bazë reale dhe kryesisht nisur nga perceptime mediatike dhe informacione personale. Në asnjë rast nuk na rezultoi se qytetarët kanë informacion të saktë ose të përafërt me totalin e shpenzimeve (në shifër ose në përqindje) në fushën e investimeve. I njëjti përfundim vlen edhe për pyetjen në lidhje me shpenzimet për shërbimeve publike. Edhe këtu përgjigjet ishin evazive, nga 5% në 50% të buxhetit bashkiak.

Të pyetur nëse ka pasur ndonjë investim konkret nga bashkia në lagjen ku qytetari banon, dhe nëse po, a kanë dijeni ata për firmën zbatuese dhe kostot e investimit, rezultoi se

- 34% nuk kanë asnjë informacion të tillë për shkak se nuk kanë dijeni se po investohet në zonën e tyre.
- 16% deklarorin se janë në dijeni, por nuk kanë njohuri për firmën zbatuese dhe as buxhetin e investimit;
- 8% mendojnë se ka investime të pjesshme, por nuk dinë detajet;
- 5% kanë informacione indirekte se diku në zonë ka investim, por nuk kanë informacion konkret;
- 2% nuk mbajnë mend kur është bërë investimi i fundit në zonën e tyre të banimit, etj.


Nga 165 përgjigje të ndryshme për këtë pyetje, në 18 raste banorët janë në gjendje të citojnë një emër firme që po bën investime në zonë, kryesisht firma të njohura në punë publike që merren edhe me rrugët lokale ose me projekte të mëdha në zonat e banuara, por në asnjë rast nuk ka njohuri të plota

rreth buxhetit të projektit dhe afatet e zbatimit të tij. Në 5 raste ka informacion të përgjithshëm për kostot e investimit (jepen shifra të ndryshme investimi, sipas informacionit që kanë dëgjuar nga të tjerë). Në 7 raste banorët deklarojnë se firma financuese është anonime, pa emër dhe akuzojnë për raste korruptive dhe vetëm 0.3% e të pyeturve mendojnë se të gjitha praktikatat e investimit janë transparente.

4.7. SA TRANSPARENTE JANË BASHKITË NË AKTIVITETIN / VENDIMMARRJEN E TYRE?

Qytetarët u pyetën në lidhje me transparencën e bashkive në aktivitetin dhe në vendimmarrjen e tyre. Nga të dhënat në nivel qarku rezulton se vetëm 7.5% e qytetarëve i shohin bashkitë dhe vendimet e tyre shumë transparente dhe 15% mjaftueshëm transparente. Kategoria më e kuotuar ishte ajo e vlerësimit “pak transparente” me rreth 30%, ndjekur nga kategoria “pjesërisht transparente” me 25%. Kategoria më kritike, “nuk janë aspak transparente” zë rreth 20% ose rreth tre herë më shumë se kategoria më vlerësuese nga ana e qytetarëve.

SA MENDONI SE BASHKIA JUAJ ËSHTË TRANSPARENTE NË VEPRIMTARINË DHE VENDIMET E SAJ?



Duke u ndalur në përfundimet e anketimit tek secila bashki më vehte, rezulton se bashkia me nivekin më të lartë të transparencës, në perceptimin qytetar, është bashkia Vorë me 19%, në distancë të madhe nga vendi i dytë, bashkia Kavajë me 8,3%.

SA ËSHTË BASHKIA TRANSPARENTE NË VEPRIMTARINË DHE VENDIMET E SAJ?


PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Shumë transparente	4,1%	8,3%	5%	6,7%	1%	19%
Mjaftueshëm transparente	18,2%	7,5%	11,8%	13,4%	7%	29,9%
Pjesërisht transparente	31,8%	19,2%	29,4%	18,5%	18%	26,5%
Pak transparente	28,2%	34,2%	32,8%	23,5%	43%	22,4%
Aspak transparente	17,3%	30,8%	17,6%	31,9%	26%	2%
Pa përgjigje	0,5%	0	3,4%	5,9%	5%	0

Bashkia Rrogozhinë ka gjithashtu një koeficient vlerësimi maksimal më të lartë sesa Tirana (6,7% ndaj 4,1%) dhe se diferenca midis Tiranës qytet dhe Tiranës rurale është minimale. Bashkia Kamëz ka vlerësimin më negativ të transparencës, me vetëm 1%. Edhe në kategorinë “mjaftueshëm transparente” Kamza zë pozitën e fundit, ndjekur nga Kavaja, kurse Vora ruan vlerësimin më pozitiv me 29%, ndjekur ng Tirana me 18%. Në vlerësimin negativ, “aspak transparente” rivalizojnë Kavaja e Rrogozhina me nga 30-31%, Kamza me 26% dhe Tiranë ka të njëjtën kuota në zonën urbane e rurale (17%), me Vorën në fund me vetëm 2%.

4.8. SA ËSHTË HAPËSIRA E QYTETARËVE PËR MONITORIM TË BASHKISË?

Bazuar në të dhënat mbi transparencën dhe njohuritë e qytetarëve mbi aktivitetin e bashkive, qytetarët u pyetën se, në rastin e projekteve të ndryshme të zbatuara nga Bashkia ku ata jetojnë, sa mendonin që kanë mundësi për monitorim (kontroll) të zbatimit të tyre në terren.

Në nivel qarku përgjigjet tregonin se mbi 40% e qytetarëve mendojnë se nuk kanë asnjë mundësi monitorimi të projekteve në bashki, “pak” mundësi deklarojnë 18%, “disi” deklarojnë 16%, “mjaftueshëm deklarojnë 10% dhe se vetëm 7% të qytetarëve deklarojnë se kanë mundësi të plota monitorimi të zbatimit të projekteve të bashkisë në zonën ku ata banojnë.



Në nivel bashkish dhe krahasimi midis tyre, rezulton se qytetarët më optimistë janë ata të Vorës, ku vetëm 18% mendojnë se nuk kanë asnjë mundësi monitorimi të ndjekjes së zbatimit të projekteve të bashkisë në zonën e tyre, kurse bashkitë tjera luhaten midis 39% (Tirana) në 50% (Kavaja).

Në kategorinë e përgjigjeve “plotësisht” mundësi për monitorim, banorët e Vorës kanë vlerësimin më optimist, me 28%, shumë më tepër sesa të gjitha bashkitë e tjera të marra së bashku. Ky koeficient në Tiranë është vetëm 0.9%, në Rrogozhinë 0.8%, kurse në njësitë e tjera luhatet midis 4-4,2%

NË RASTIN E PROJEKTEVE TË NDRYSHME TË ZBATUARA NGA BASHKIA JUAJ, SA MENDONI QË QYTETARËT KANË MUNDËSI PËR MONITORIM TË ZBATIMIT TË TYRE NË TERREN?						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Aspak	39,1%	50,8%	46,2%	49,6%	43%	18,4%
Pak	26,4%	10%	17,6%	18,5%	24%	12,9%
Disi	20,5%	13,3%	21%	12,6%	14%	15%
Mjaftueshëm	8,6%	9,2%	7,6%	9,2%	6%	20,4%
Plotësisht	0,9%	4,2%	3,4%	0,8%	4%	28,6%
Pa përgjigje	4,5%	12,5%	4,2%	9,2%	9%	4,8%
Total	100%	100%	100%	100%	100%	100%

4.9. CILAT JANË FORMAT E NJOFTIMIT TË QYTETARËVE?


Me përhapjen e ligjit mbi të drejtën e informimit dhe zgjerimin e projekteve të ndryshme vendore e ndërkombëtare për krijimin e sistemeve transparente të Bashkive në drejtim të informimit për qytetarët, është e pritshme që qytetarët të kenë akses më të madh në shfrytëzimin e faqeve online të bashkive dhe informimit përmes tyre. Vetë drejtuesit dhe administrata e bashkive i referohen vazhdimisht faqes online si burime informacioni publike dhe si tregues të transparencës. Por nga anketimi i kryer nga ISP rezulton se numri i qytetarëve që përdorin këtë kanal komunikimi dhe informimi është i vogël.

Në anketim qytetarët u pyetën mbi mënyrat kryesore me të cilat ata marrin njoftimet për veprimtaritë e bashkive, referuar zonave ku vetë qytetarët e anketuar banojnë. Në tabelën referuese u ofruan alternativat e marrjes së informacionit përmes faqes online të bashkisë, përmes medias sociale, përmes afishimeve në mjediset publike të bashkisë, përmes komunikimit telefonik me bashkinë ose përmes pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit Bashkiak.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhënat në total për bashkitë: sipas tyre, 71.8% e qytetarëve nuk përdorin faqen online të bashkisë për informimin e tyre, 82% nuk aplikojnë informimin përmes telefonit në bashki dhe se 83% nuk informohen përmes komunikimit me kërkesa adresuar bashkisë ose këshilltarëve. Ndërkohë dy format më informuese për qytetarët janë: përmes rrjeteve sociale të bashkisë dhe drejtuesve të saj apo përmes informacioneve të ndryshme në mediat sociale (37,6%) dhe përmes formës klasike të informimit në njoftimet e publikuara në ambientet e bashkive/njësive (35,5%).

FORMAT E INFORMIMIT TË QYTETATËVE

■ PO ■ JO ■ Pa përgjigje




Duke analizuar secilën bashki më vete, në treguesin e informacionit që merret nga faqja zyrtare e bashkisë, (trendi i informimit, ku edhe bashkitë janë fokusuar dhe ku jepen shumica e njoftimeve), rezulton se numri i qytetarëve që klikojnë për informacion lidhet edhe me zonën ku qytetarët banojnë dhe aksesin e tyre në burimet e tjera të informimit.

Bashkia Vorë ka numrin më të madh të qytetarëve që kërkojnë informacion përmes faqes së internetit, (32%), ndjekur nga qytetarët e bashkisë Tiranë (29%). Bashkitë Kavajë e Kamëz kanë të njëjtit tregues (19%), kurse bashkia Rrogozhinë dhe RURALE e bashkisë Tiranë kanë po ashtu të njëjtat kuota, rreth 10%. Diferencat midis bashkive dhe zonave kanë shpjegim edhe me vetë natyrën e bashkive, shtrirjen dhe cilësinë e aksesit dhe të informacioneve që ofrohen në faqet e internetit të bashkive.

INFORMIMI NGA FAQJA ONLINE E BASHKISË


■ Pa përgjigje ■ Jo ■ Po




Informimi përmes rrjeteve sociale, - sidomos mediave të reja facebook, instagram, etj, zë vend të rëndësishëm për banorët e Tiranës (mbi 54% informohen përmes tyre), për banorët e Vorës (rreth 45%) dhe ata të Kamzës (40%), por ka përqindje minimale në rastin e bashkisë Rrogozhinë me vetëm 14,3%. Bashkia Kavajë ka gjithashtu përqindje të ulët të qytetarëve që informohen përmes mediave sociale të bashkisë dhe drejtuesve të saj, me vetëm 25%, thuajse 20% më pak sesa mesatarja e banorëve të qytetit të Tiranës.

RRJETET SOCIALE (FACEBOOK, INSTAGRAM ETC)

■ Po ■ Jo ■ Pa përgjigje




Lidhur me formën klasike të informimit mbi bashkinë dhe vendimmarrjet e saj, - afishimi i të dhënave në këndet e informimit në bashki (mure, xhama, etj), duket se Vora ka shifrën rekord të qytetarëve që përdorin këtë formë me rreth 70%, ndjekur nga Kavaja me 45,8%. Bashkitë e tjera kanë përqindje dukshëm më të vogël, me rekord Rrogozhina me 19%, zonat e periferisë së Tiranës me 20%, qyteti i Tiranës me 27% dhe Kamza me 29%.



Të pyetur nëse qytetarët përdorin formën e komunikimit direkt me telefon me zyrën e informacionit në bashki dhe në njësitë administrative, rezultoi se kjo formë komunikimi ka mbështetje minimale në raport me format e tjera të komunikimit. Konkretisht, në Vorë 27% e qytetarëve pohojnë se kanë kryer telefonata në bashki për problematika të caktuara, kurse në bashkitë e tjera përqindja e qytetarëve që përdorin këtë formë informimi e komunikimi luhetet midis 2,5% në Rrogozhinë dhe zonat periferike të Tiranës, në 5-6% në bashkitë Kavajë, Kamëz e qytetin e Tiranës.

DUKE TELEFONUAR BASHKINË (ZYRA E INFORMIMIT)


■ Po ■ Jo ■ Pa përgjigje



Legjislacioni u njuh të drejtën qytetarëve të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe në takime konsultative. Në secilin nga takimet e zhvilluara midis komuniteteve lokale dhe Këshillit Bashkiak është theksuar prej këtyre të fundit, mbështetja parimore e të drejtës për pjesëmarrje qytetare në mbledhje dhe në procesin e konsultimeve publike, por praktikisht rezultojnë se ky komponent i rëndësishëm i transparencës dhe vendimmarrjes së përbashkët thuajse është jo funksional.

DUKE MARRË PJESË NË MBLEDHJEN E KB / KONSULTIME

■ Po ■ Jo ■ Pa përgjigje



Konkretisht vetëm në rastin e bashkisë Vorë pranohet se 13% e qytetarëve kanë marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit ose në takimet e konsultimit publik të organizuara nga Këshilli ose Kryetari. Në bashkitë e tjera rezultatet janë simbolike.


Në Tiranë, Kavajë e Kamëz vetëm rreth 6% e qytetarëve kanë marrë pjesë në mbledhjet e këshillit bashkiak ose në konsultimet publike të zhvilluara nga bashkia dhe strukturat e saj. Në zona të ndryshme,

sic janë zona periferike e Tiranës (ish komunat) përqindja është më e vogël, rreth 4%), kurse në Bashkinë Rrogozhinë është shënuar kuota më e ulët me vetëm 1,7% të qytetarëve.

4.10. SA APLIKOHEN KËRKESAT ADRESUAR KËSHILLIT BASHKIAK?

Me ligjin mbi të drejtën e informimit qytetarët mund të informohen edhe përmes komunikimit me shkrim me bashkinë, me institucionet e saj të varësisë, me këshilltarët bashkiakë dhe njësinë administrative, etj. Të pyetur se sa përqind e qytetarëve kanë aplikuar këtë formë komunikimi rezultoi se në Tiranë dhe Vorë përqindja luhet midis 9% dhe 10%, kurse në bashki si Kavaja vetëm 0.8% e qytetarëve.

Në bashkitë e tjera, përfshirë Rrogozhinë e Kamëz ka rezultate të ndërmjetme, përkatësisht 8 dhe 5,9%. Zonat e periferisë së Tiranës kanë përqindje shumë më të ulët (më shumë se dy herë) në raport me banorët e qytetit të Tiranës, në aplikimin e komunikimit me kërkesa me shkrim drejtuar autoriteteve të ndryshme lokale.




Pjesë e anketimit ishin edhe alternativa të tjera të përdorura nga qytetarët për të komunikuar me bashkinë dhe për tu njohur me vendimmarrjet e tyre. Nga të dhënat shtesë rezultoi se informimi përmes medias (gazeta dhe TV) zë 13,9% në zonat e periferisë së Tiranës dhe 9% në bashkinë Kamëz, 6% në Kavajë dhe 3,2% në qytetin e Tiranës. Po ashtu, qytetarët deklarojnë se burim informacioni në 8,2% të rasteve në Kavajë, 14,6% të rasteve në Vorë, 7% të rasteve në Kamëz dhe 2.4% në rastin e periferisë së Tiranës, - ka qenë informimi nga rrethi familjar dhe shoqëror i tyre.

5. KONSULTIMI DHE MIRËQEVERISJA LOKALE

Një prej risive thelbësore të reformës së re territoriale është përfshirja e konceptit të konsultimit publik midis bashkisë dhe qytetarëve, për të gjitha vendimmarrjet e rëndësishme. Me standardet e konsultimit lidhet edhe standardi i mirëqeverisjes. Në funksion të matjes së perceptimit qytetar mbi aplikimin e standardeve të konsultimit publik ISP adresoi një bllok pyetjesh që kanë të bëjnë me raportin midis zgjedhësve dhe të zgjedhurve, mënyrën e komunikimit me institucionet, bilancin e konsultimeve dhe sugjerimet e mundshme për përmirësime në të ardhmen.

5.1. SA EFEKTIVE JANË KONSULTIMET E BASHKISË/KËSHILLIT?

Qytetarët u pyetën sesa besonin ata se janë efektive konsultimet të ndryshme / takime personale të këshilltarëve me komunitetin lokal. Në nivel qarku vlerësimet ishin skeptike, - 36% mendojnë se konsultimet me këshilltarët dhe komunitetin nuk janë efektive, dhe vetëm 6.5% mendojnë se janë shumë efektive. Në kategoritë e tjera dominuese janë përgjigjet skeptike, rreth 20% e qytetarëve mendojnë se konsultimet midis këshilltarëve bashkiakë e komunitetit janë pak apo pjesërisht efektive. Në këto përgjigje mund të ketë ndikuar natyra sesi zhvillohen konsultimet në praktikën e bashkive tona, kryesisht të ideuara si takime formale ose takime të forcë politike të kryetarit të bashkisë ose partisë që ka shumicën në këshillin bashkiak.



Referuar bashkive të veçanta, nga të dhënat e pasqyruara në tabelën bashkëngjitur rezultojnë se shifrën më të lartë pozitive e kanë dhënë banorët e Vorës me 38% (plotësisht dhe mjaftueshëm), ndjekur nga banorët e qytetit të Tiranës me 23,2%, ata të Rrogozhinës me 20,1%. Në vendet e fundit me shifra vlerësuese pozitive ndodhen banorët e Kamzës me 15%, ata të Kavajës me 11,7% dhe banorët e periferisë së qytetit Tiranë me vetëm 7,5% mbështetje.

Në rastin e banorëve të qytetit të Tiranës rezultojnë se vlerësimi negativ “aspak pozitiv” është kategoria më e mbështetur me 26,4% të banorëve të pyetur, ndjekur nga kategoria “disi” me rreth 26% e të pyeturve. Në Bashkinë Kavajë kategoria “aspak” në vlerësimin e efektivitetit të konsultimeve të ndryshme me këshilltarët dhe komunitetin zë vendin kryesor në përgjigje me 49% e të pyeturve, ose një

në çdo dy të pyetur. Edhe në periferinë e Tiranës ruhet i njëjti trend me 48,7%, kurse rekord është bashkia Rrogozhinë me vlerësim negativ të 50,4% e të pyeturve. Në Kamëz kategoritë e vlerësimit “pak” dhe “aspak” kanë të njëjtën përqindje, 37%, në total 74% vlerësim negativ për besueshmërinë e procesit të konsultimeve të ndryshme.

Përgjigjet e ardhura nga anketimi i kryer në territorin e bashkisë Vorë janë shumë më mbështetëse dhe më optimiste sesa në secilën prej bashkive të tjera, duke i dhënë mbështetje me 26,5% vlerësimit “disi”, vlerësimi më i lartë në pesë bashkitë, si dhe vlerësimin më të ulët kategorisë “aspak efektive” me vetëm 17% ose 10% më pak sesa përfundimi në qytetin e Tiranës.

SA BESONI SE JANË EFEKTIVE KONSULTIMET TË NDRYSHME / TAKIME PERSONALE TË KËSHILLTARËVE ME KOMUNITETIN TUAJ?

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Plotësisht	8,2%	0	2,5%	6,7%	3%	15%
Mjaftueshëm	15%	11,7%	5%	13,4%	12%	23,1%
Disi	25,9%	15%	16,8%	19,3%	11%	26,5%
Pak	20,5%	24,2%	20,2%	8,4%	37%	15,6%
Aspak	26,4%	49,2%	48,7%	50,4%	37%	17%
Pa përgjigje	4,1%	0	6,7%	1,7%	0	2%

5.2. CILAT JANË FORMAT / VENDET E PREFERUARA PËR TAKIME NGA QYTETARËT?

Të pyetur nëse ndonjë nga qytetarët ka takuar të paktën një këshilltar bashkiak gjatë këtij mandati për një problem / shqetësim të qytetarit, në total në nivel qarku 35% deklaruan se nuk kanë pasur asnjëherë takime të tilla personale. Për ata që kanë pasur takime, pyetja iu adresua se ku është zhvilluar takimi. Në nivel qarku rezultoi se 19% e takimeve janë bërë në mjediset e bashkisë, 7.9% në kafe, 4% në zyrat e partisë politike të këshilltarit, dhe 1.6% në mjedise të tjera publike. Pjesa tjetër e qytetarëve dha përgjigje alternative për forma të tjera takimesh.

Të pyetur se ku do të dëshironin të takonin në të ardhmen këshilltarët e zonës së tyre, qytetarët në shumicë absolute 75.9% preferojnë takimin në bashki, 7% në zyrat e partisë politike që i përket këshilltari, vetëm 4.8% preferon takimin në kafe me këshilltarë dhe shumë më pak, vetëm 2.2% preferojnë takimet në terren. Pjesa tjetër e përgjigjeve ofrojnë alternativa të tjera takimi, në mjedise publike, familjare, personale, etj. Fakti që shumica preferon takimet në bashki, meriton vëmendje për të krijuar mekanizma funksionale dhe mundësi që të ketë një sistem efektiv takimesh në bashki dhe në institucionet e varësisë së saj, si dhe për një korrektrim të vetë punës së këshilltarëve, - kalim nga zyra e punës tek takimet me elektoratin ku ai ndodhet.


Referuar bashkive të qarkut Tiranë, mbi 72% në Tiranë, 80% në Kavajë, 72% në Rrogozhinë, 79% në Kamëz dhe 76% në Vorë preferojnë takimin me këshilltarët në mjediset e bashkive. Alternativa e dytë më e preferuar e këshilltarëve ndryshon nga bashkia në bashki. Në Rrogozhinë preferenca për takimin në kafe është shumë e lartë, 12.6%, tre herë më e lartë sesa në bashkinë Tiranë, ndërkohë që banorët e periferisë së Tiranës kanë gjithashtu preferenca kundër takimeve në kafe, rreth dy herë më pak sesa banorët e qytetit Tiranë. Preferenca e takimeve në kafe është e njëjtë në Tiranë, Vorë e Kamëz, por më e vogël në Kavajë, kurse preferenca për takimet në zyrat e partisë politike të këshilltarëve është më e lartë në Vorë, Kamëz e Tiranë (përkatesisht 15%, 9% dhe 6.8%) dhe krejtësisht minimale (1%) në rastin e

bashkisë Rrogozhinë. Këto përgjigjen shpjegojnë edhe zonat ku partitë kanë më shumë ndikim tek qytetarët dhe ku perceptimi qytetar mbi shanset që iu ofrojnë partitë janë më të mëdha në trajtimin e problematikave që qytetarët votues kanë.

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T- RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Në kafe	4,1%	2,5%	2,5%	12,6%	4%	4,1%
Në zyrën e partisë	6,8%	4,1%	5,9%	1,7%	9%	15%
Në bashki	72,3%	80,8%	79,8%	72%	79%	76,2%
Pa përgjigje	11,4%	6,9%	5,9%	9,2%	2%	2,7%
Tjetër	5,4%	5,7%	5,9%	4,5%	6%	2%

5.3. SA NJIHEN KËSHILLTARËT LOKALË NGA QYTETARËT?

Qytetarët u pyetën më pas sesa këshilltarë bashkiakë njihin nga lista e të gjithë këshilltarëve bashkiakë në bashkinë e tyre. Siç rezulton edhe nga tabela ilustruese, 65% e personave të anketuar nuk ishin në gjendje të evidentonin asnjë këshilltar bashkiak në territorin e bashkisë ku jetojnë. Një pjesë e tyre ishte në gjendje të konfirmonte indirekt (përmes TV apo informacioneve indirekte) mbi ndonjë emër të mundshëm të këshilltarëve lokalë, por në tërësi 65% nuk ishin në gjendje të konfirmonin 100% njohjen dhe identifikimin me emër të ndonjë këshilltari në bashki. Duke pasur parasysh se një pjesë e konsiderueshme e anketimeve janë zhvilluar në zonat urbane ku ndodhen edhe zyrat e bashkisë dhe zhvillon aktivitetin edhe këshilli bashkiak, shifra prej 65% është jashtëzakonisht e lartë dhe tregues i lidhjeve të dobëta midis qytetarëve dhe këshilltarëve bashkiakë në secilën bashki.



Në kategoritë e tjera të njohjes, 7.9% e të anketuarve ishin në gjendje të konfirmonin një emër këshilltari bashkiak, 5.6% ishin në gjendje të konfirmonin dy këshilltarë bashkiakë, 2.9% ishin në gjendje të konfirmonin 3 këshilltarë bashkiakë, 3.2% ishin në gjendje të konfirmonin 4 këshilltarë bashkiakë, dhe


nga 1.2% ishin në gjendje të konfirmonin 6 ose 7 këshilltarë bashkiakë. Në total, vetëm 0.4% ishin në gjendje të konfirmonin pothuajse shumicën e anëtarëve të këshillit bashkiak në bashkinë ku ata jetonin.

Duke analizuar të dhënat për secilën bashki, rezultoi se këshilltarët e bashkisë Vorë kanë njohje më të madhe nga qytetarët e tyre. Në Vorë numri i qytetarëve që nuk është në gjendje të identifikojë asnjë këshilltarë bashkiak është 71%, shumë më i vogël sesa shifra 84%-88% në Kavajë, Kamëz e Tiranë, dhe akoma më larg nga diferenca e thellë me 90% në zonat rurale të Tiranës dhe 95% në bashkinë e Rrogozhinës. Teza se sa më e vogël të jetë bashkia aq më e lehtë identifikohen këshilltarët mund të gjejë mbështetje në rastin e Vorës por jo në rastin e Rrogozhinës. Në Tiranë, diferenca midis zonës urbane dhe rurale është e shpjegueshme edhe me faktin se shumica absolute e anëtarëve të këshillit bashkiak Tiranë janë banorë të qytetit të Tiranës.

SA KËSHILLTARË BASHKIAKË NJIHNI NË BASHKINË TUAJ? SIPAS BASHKIVE NË QARK						
NR	TIRANA	KAVAJA	T-RURALE	RROGOZHINA	KAMZA	VORA
0	88,6%	84,2%	90,7%	95,8%	85%	71,4%
1	3,6%	3,3%	3,4%	0,8%	9%	4,1%
2	1,4%	0,8%	3,4%	0,8%	1%	6,1%
3	1,8%	2,5%	1,7%	1,7%	2%	2%
4	0,5%	0,8%	0,8%	0,8%	2%	1,4%

5.4. SA NJIHEN KËSHILLTARËT QË JANË BANORË NË ZONËN E TË ANKETUARIT?

Qytetarët u pyetën nëse janë në gjendje të pohojnë se njohin personalisht ndonjë këshilltar bashkiak që është banor në zonën ku vetë qytetari banoni. Në nivel qarku, 69% e të pyeturve nuk njihnin asnjë emër këshilltari banor në të njëjtën lagje ose njësi, kurse 26% konfirmonin se kanë informacione direkt ose indirekt se ndonjë këshilltar i bashkisë banon në të njëjtën zonë me vetë qytetarin e anketuar. Pjesa tjetër, rreth 4.7% nuk ishte në gjendje të jepte një përgjigje shteruese në lidhje me këtë pyetje. Pyetja ka vlerë për të kuptuar më mirë përputhshmërinë midis mandatit të këshilltarëve lokalë dhe shtrirjes demografike të vetë banorëve zgjedhës në territorin e bashkisë. Reforma supozon se duhet të ketë përputhshmëri të lartë midis përbërjes së popullsisë dhe mandateve të tyre të përfaqësimit, megjithatë përfaqësimi proporcional është çështje vullneti politik i vetë partive dhe jo një detyrim ligjor.



Të dhënat sipas bashkive të qarkut Tiranë ofrojnë diferenca në informacionin e qytetarëve dhe vendbanimin e këshilltarëve. Konkretisht, në Tiranë (qytet) 80% nuk njohin asnjë këshilltar që banon në të njëjtën zonë me të anketuarin, kurse në Tiranë (periferi) përqindja është edhe më e lartë, 84%. Në Kamëz është shifra e dytë më e lartë e përqindjes se qytetarëve që nuk njohin asnjë këshilltar banor në të njëjtën zonë (74%). Në Kavajë kjo përqindje është rreth 70%, dukshëm në diferencë me rezultatin e bashkisë Rrogozhinë ku 52% e qytetarëve deklarojnë se nuk njohin ndonjë këshilltar banor në të njëjtën zonë banimi. Në Vorë kemi rezultatin më të mirë, ndarje gati të barabartë 47% me 48% të qytetarëve që janë në gjendje të njohin këshilltarë lokalë që banojnë në të njëjtën zonë me të anketuarit, dhe po ashtu, qytetarë që nuk janë në gjendje të identifikojnë ndonjë këshilltar.


A NJIHNI NDONJË KËSHILLTAR QË ËSHTË BANOR NË ZONËN KU JU BANONI?

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Po	15,9%	23,3%	10,9%	42,9%	20%	47,6%
Jo	80,9%	69,2%	84%	52,9%	74%	48,3%
Pa përgjigje	3,2%	7,5%	5%	4,2%	6%	4,1%

5.5. SA % E QYTETARËVE NUK JANË FTUAR NË ASNJË KONSULTIM LOKAL?

Qytetarët janë pyetur se sa herë janë ftuar nga bashkia apo këshilltarët për konsultim lidhur me problematika të ndryshme lokale, sidomos në prag të mbledhjeve të këshillave bashkiake dhe të vendimmarrjeve që përfshijnë komunitetin. Nga përgjigjet e tyre krahasuese rezultojnë se në total, mbi 86% e qytetarëve nuk janë ftuar asnjëherë në konsultime nga bashkia dhe këshillat bashkiakë, mbi 3% janë ftuar vetëm 1 herë, mbi 2% vetëm 2 dhe 3 herë, mbi 1% mbi 4 deri 6 herë.

SA HERE JENI FTUAR NE KONSULTIME BASHKIAKE PER PROBLEMET E ZONES?



Në bashkinë Tiranë 88% e qytetarëve deklarojnë se nuk janë ftuar asnjëherë, 2.3% e qytetarëve deklarojnë se janë ftuar një deri në dy herë, dhe pjesa tjetër e përgjigjeve (3, 4, 6, 20 herë) zënë peshë minimale deri në 0.9%. Në bashkinë Kavajë gjithashtu mbi 88% e qytetarëve deklarojnë se nuk janë ftuar asnjëherë për konsultime dhe takime nga bashkia apo këshilltarët, ndërkohë që numri i atyre që konfirmojnë se janë ftuar nga 1 në 4 herë është më i lartë sesa në Tiranë, rreth 2.5% deri në 3.3%, por në thelb, i papërfillshëm në numrin total të banorëve të kësaj bashkie.

SA HERË JENI FTUAR NGA BASHKIA APO KËSHILLTARËT PËR KONSULTIM PËR PROBLEMATIKA/ÇËSHTJE TË NDRYSHME, PËRPARA SE ATO TË DISKUTOHEN NË KËSHILL?

NR	TIRANË	KAVAJË	KAMËZ	VORË	RROGOZHINË	MESATARE
0	88,3%	88,3%	92%	74,1%	89,9%	86,52%
1	3,3%	3,3%	1%	4,1%	4,2%	3,18%
2	2,5%	2,5%	3%	2,7%	0,8%	2,3%
3	2,5%	2,5%	2%	4,1%	3%	2,82%
4	0,8%	0,8%	1%	1,4%	2%	1,2%
6	1,7%	1,7%	1%	4,1%	0,5%	1,8%

Në Bashkinë Rrogozhinë rreth 90% e qytetarëve nuk kanë pasur ftesë asnjëherë për të marrë pjesë në konsultime nga Bashkia apo Këshilli Bashkiak, ndërkohë që numri i atyre që konfirmojnë se kanë pasur të paktën një ftesë është 4.2%, shifra më e lartë në të gjitha bashkitë në këtë kategori. Në bashkinë Kamzës numri i qytetarëve që nuk kanë pasur asnjë ftesë për konsultime është gjithashtu shumë e lartë, 92%, dhe se numri i atyre që kanë pasur të paktën dy ftesa është 3%, shifër minimale por më e lartë sesa Tirana, Kavaja, Vora e Rrogozhina në plan krahasimor. Në bashkinë Vorë 74% kanë deklaruar se nuk kanë pasur asnjë ftesë për konsultime, shifër e lartë, por në krahasimin midis pesë bashkive, mbetet shifra më pozitive. Numri i qytetarëve që kanë deklaruar se janë ftuar 3-4-5-6 ose më shumë herë për konsultime është relativisht i lartë në krahasim me bashkitë e tjera, përkatësisht 4,1%, 1.4%, 4.1%, 0.7%, etj.

5.6. SA ËSHTË BESIMI QYTETAR TEK TË ZGJEDHURIT LOKALË?

Qytetarët u pyetën mbi besimin që ata kanë tek funksionarët e zgjedhur dhe drejtues vendorë, përfshirë kryetari i bashkisë, këshilltari bashkiak, kryetari i qarkut, prefekti dhe administratori i njësisë në bashki, mbi kriterin, se sa efektive e kontribuues janë ata në zonën përkatëse. Në nivel qarku, kryetarët e bashkive nuk kanë besim në 25% të rasteve, kanë plotësisht besim në 22.8% të rasteve dhe besim të pjesshëm në 21.6% të përgjigjeve. Në kategorinë e këshilltarëve bashkiakë vlerësimi është kryesisht negativ, ku dominuese është kuota 37% e mungesës totale të besimit dhe 44% me pak ose pjesërisht

besim. Kategoria e vlerësimit maksimal pozitiv zë vetëm 5%, rreth 4-5 herë më pak sesa besimi ndaj institucionit të kryetarit të bashkisë. Tek institucioni i kryetarit të qarkut kuotat dominuse janë mosbesuese: aspak besim 38% dhe pak ose pjesërisht besim rreth 40% e të pyeturve. Në kategorinë e Prefektit gjithashtu kurba është dominuese mosbesuese, me 41.6% mosbesim të plotë dhe rreth 24% pak ose pjesërisht besim. Lidhur me administratorin e njësisë ka një shpërndarje më proporcionale, nga 10% në 15% në të gjitha përgjigjet alternative.

Perceptimi qytetar në lidhje me këto funksione dhe mundësia që ato të kontribuojnë pozitivisht në jetën dhe komunitetin e tyre, lidhet edhe me sistemin elektoral dhe me piramidën e kompetencave që ka secili prej këtyre institucioneve.

SA BESIM KENI / QE KONTRIBON ME SHUME PER ZONEN TUAJ?

PERGJIGJET ALTERNATIVE	KRYETARI I BASHKISË	KËSHILLTARI BASHKIAK	KRYETARI I QARKUT	PREFEKTI NE QARK	ADMINISTRATORI I NJËSISË
Plotësisht besim	22,8%	5,1%	2,5%	2,7%	10,9%
Shumë besim	13,7%	8,7%	3,6%	2,2%	11,3%
Disi besim	21,6%	21,6%	12,4%	8,8%	17,5%
Pak besim	15,3%	24,2%	17%	15,8%	13,1%
Aspak besim	25%	37,1%	38,1%	41,6%	15,8%
Pa përgjigje	1,7%	3,3%	26,4%	29%	41,6%

5.7. SA ËSHTË BESIMI QYTETAR TEK KËSHILLTARËT BASHKIAKË?

Referuar të dhënave të anketimit në secilën prej 5 bashkive në qarkun Tiranë tabela ilustron përfundimet lidhur me vlerësimin tek këshilltarët dhe rolin e tyre kontribuues në problematikat lokale që shqetësojnë qytetarët. Sic rezulton edhe nga tabela, vlerësimi maksimal pozitiv (plotësisht besim) është i lartë në bashkinë Vorë (15%) dhe dyfish më i ulët në bashkinë Rrogozhinë (6.7%) kurse në bashkitë e tjera është në vlera minimale nga 1.8% në 3.3%. Tirana ka kuotat më të vogla të besimit tek këshilltarët bashkiakë, ndjekur nga Kamza dhe më pas Kavaja. Vlerësimi për këshilltarët në Tiranë nuk ka diferencë midis zonës urbane dhe rurale.

Në vlerësimin maksimal negativ (aspak besim) përqindjen më të lartë e ka Rrogozhina me 50%, ndjekur nga Kamza me 48%, Kavaja 45%, Tirana urbane dhe rurale me nga 39% dhe 34% dhe në fund, kuotat minimale negative gjenden në Vorë me vetëm 14% vlerësim se këshilltarët nuk kanë aspak besim në funksionin e tyre kontribuues për qytetarët.

BESIMI TEK ANËTARËT E KËSHILLIT BASHKIAK

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Plotësisht besim	1,8%	3,3%	1,7%	6,7%	2%	15%
Shumë besim	5%	7,5%	9,2%	6,7%	1%	21,8%
Disi besim	25,9%	18,3%	15,1%	21%	18%	25,9%
Pak besim	26,8%	23,3%	31,1%	13,4%	28%	21,8%
Aspak besim	34,1%	45,8%	39,5%	50,4%	48%	14,3%
Pa përgjigje	6,4%	1,7%	3,4%	1,7%	3%	1,4%

5.8. SA ËSHTË BESIMI QYTETAR TEK KRYETARI I BASHKISË?

Në vlerësimin për besimin dhe rolin kontribuues të kryetarit të bashkisë në secilën prej bashkive të qarkut Tiranë, rezultojnë se ka ndryshime të dukshme me perceptimin mbi këshilltarët. Konkretisht, në Vorë e Tiranë rezultojnë se kryetari i bashkisë ka kuotën më të lartë kuotën pozitive “plotësisht besim” me përkatësisht 44.2% dhe 24.5%. Në bashkitë e tjera kuota maksimale vlerësuese shkon nga 8% në Kamëz në 16% në Rrogozhinë e 17% në Kavajë. Ndërsa në vlerësimin maksimal negativ (aspak besim), kuotat më negative i gjejmë në Rrogozhinë, Kavajë e Kamëz (40%, 37% dhe 36%), kurse në Tiranë ka diferencë midis zonës urbane e rurale, përkatësisht 12.7% dhe 31.9%. Në bashkinë Vorë vlerësimi maksimal negativ për kryetarin e bashkisë dhe rolin e tij kontribuues në problematikat qytetare është gjithashtu minimal, vetëm 7.5%.

Një lexim më i thelluar i këtyre rezultateve nuk lidhet direkt me mbështetjen për kryetarët, sa lidhet me perceptimin e qytetarëve mbi pushtetin real të kryetarëve të bashkisë në zgjidhjen e problematikave dhe kontributin në zonën përkatëse administrative.

BESIMI TEK KRYETARI I BASHKISË						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Plotësisht besim	24,5%	17,5%	16,8%	16,8%	8%	44,2%
Shumë besim	22,7%	5,8%	14,3%	7,6%	4%	17,7%
Disi besim	23,2%	23,3%	24,4%	18,5%	23%	17%
Pak besim	15,9%	15%	11,8%	13,4%	25%	12,2%
Aspak besim	12,7%	37,5%	31,9%	40,3%	36%	7,5%
Pa përgjigje	0,9%	0,8%	0,8%	3,4%	4%	1,4%

5.9. SA ËSHTË BESIMI QYTETAR TEK KRYETARI I QARKUT?

Institucioni i kryetarit të qarkut rezultojnë të jetë gati simbolik në vlerësimin e qytetarëve mbi rolin dhe kontributin e tij në problematikat vendore. Kuotat maksimale negative “aspak besim” luhaten nga 28% në bashkinë Vorë në 36%-37% në Tiranë e Rrogozhinë, në 42% në Kavajë dhe shifra rekord 54% në Rrogozhinë. Vlerësimi maksimal pozitiv (plotësisht besim), ka marrë kuota simbolike mbështetëse nga 1% në Kamëz në 4.2% në Kavajë.

BESIMI TEK KRYETARI I QARKUT						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Plotësisht besim	1,8%	4,2%	2,5%	3,4%	1%	2,7%
Shumë besim	7,7%	0,8%	1,7%	4,2%	1%	2,7%
Disi besim	18,6%	8,3%	6,7%	10,9%	12%	12,2%
Pak besim	20%	15%	14,3%	8,4%	26%	17%
Aspak besim	37,7%	42,5%	34,5%	36,1%	54%	28,6%
Pa përgjigje	14,1%	29,2%	40,3%	37%	6%	36,7%

5.10. SA ËSHTË BESIMI QYTETAR TEK PREFEKTI?

Institucioni i prefektit, i cili në të kaluarën ka pasur një rol të rëndësishëm në qeverisjen lokale, gjithashtu ka pritshmëri dhe mbështetje minimale publike. Konkretisht, vlerat pozitive maksimale për rolin e Prefektit dhe kontributin e tij në qeverisjen vendore luhaten nga 1% në Kamëz në 5% në Rrogozhinë, - shifra të përafërta me besimin edhe për institucionin e kryetarit të qarkut.

Në vlerat maksimale negative (aspak besim) shifrat luhaten nga rreth 33% në Vorë e Rrogozhinë në 44% në Tiranë, 47% në Kavajë e 57% në Kamëz, - tendencë që u shpreh edhe për institucionin e kryetarit të qarkut. Duke qenë një qark në qendër të vendit, ku edhe ndodhet selia e qeverisë dhe e parlamentit, institucioni i prefektit nuk ka peshën specifike që mund të ketë në qarqe më periferike.

BESIMI TEK PREFEKTI						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Plotësisht besim	1,8%	3,3%	1,7%	5%	1%	3,4%
Shumë besim	4,1%	0,8%	1,7%	0,8%	1%	2,7%
Disi besim	15,9%	3,3%	5%	3,4%	12%	8,2%
Pak besim	19,5%	14,2%	10,9%	6,7%	24%	17%
Aspak besim	44,5%	47,5%	36,1%	33,6%	57%	32,7%
Pa përgjigje	14,1%	30,8%	44,5%	50,4%	5%	36,1%

5.11. SA ËSHTË BESIMI QYTETAR TEK ADMINISTRATORËT LOKALË?

Ndryshe nga institucionet e prefektit dhe kryetarit të qarkut, institucioni i ri i administratorit të njërive në bashki (ish komunat) gëzon një mbështetje më të madhe publike. Konkretisht në vlerat maksimale pozitive “plotësisht besim”, mbështetja për rolin dhe kontributin e administratorit të njësisë varion nga 5% në Tiranë e Kamëz në 10%-11% në Kavajë e Rrogozhinë, deri në 17% në Vorë dhe në Tiranën rurale.

Edhe treguesit e mosbesimit të theksuar shprehur në kategorinë “aspak besim” vlerat nuk janë të larta në krahasim me dy institucionet e tjera të cituara më lart. Konkretisht, vlerat më negative rezultojnë në bashkinë Kamëz e Kavajë me përkatësisht 54% dhe 43%, ndjekur nga Rrogozhina me 38%, Tirana urbane 29% dhe ajo rurale 36% si dhe në fund, bashkia Vorë me 22%.

BESIMI TEK ADMINISTRATORI I NJËSISË						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Plotësisht besim	5,5%	11,7%	17,6%	10,9%	5%	17%
Shumë besim	16,4%	2,5%	13,4%	4,2%	8%	17%
Disi besim	25%	10,8%	16,8%	10,9%	16%	18,4%
Pak besim	14,1%	20%	8,4%	9,2%	12%	13,6%
Aspak besim	29,1%	43,3%	36,1%	38,7%	54%	22,4%
Pa përgjigje	10%	11,7%	7,6%	26,1%	5%	11,6%

5.12. CILA ËSHTË SHPESHTËSIA E TAKIMIT ME INSTITUCIONET VENDORE

Qytetarët u pyetën se sa herë janë takuar për probleme/çështje të ndryshme të tyre me institucionet kryesore vendore, specifikiisht me kryetarin e bashkisë, këshilltarët, kryetarin e qarkut, prefektin ose administratorin e njësisë. Përgjigjet e tyre në nivel qarku janë si më poshtë në tabelë. 56% e qytetarëve nuk janë takuar asnjëherë me kryetarin e bashkisë, 69% asnjëherë me një këshilltar bashkiak, 89% asnjëherë me drejtuesin e qarkut dhe prefektin dhe rreth 60% asnjëherë me administratorin e njësisë. Tek opsioni “një herë” dominon kryetari i bashkisë dhe administratori me përkatësisht 15.9% dhe 11.9%, tek opsioni “dy herë” dominon kryetari i bashkisë me 7.4% dhe këshilltarët me 5.6%, tek opsioni “tre herë” dominon kryetari i bashkisë dhe administratori me përkatësisht 4.2% dhe 3.8%, tek opsioni “katër herë” kryetari i bashkisë dhe administratori kanë vlerësim të njëjtë 2.5%, si dhe tek opsioni “mbi katër herë” gjithashtu dominon kryetari i bashkisë dhe administratori me 13%-14%. Sic rezulton nga tabela, institucionet më të frekuentuara nga qytetarët për takime dhe parashtrim të kërkesave të tyre janë kryetari i bashkisë dhe administratori i njësisë.

QARK: SA HERË JENI TAKUAR PËR PROBLEME TË NDRYSHME ME KETO INSTITUCIONE					
PERGJIGJET	KRYETARI I BASHKISË	KËSHILLTARI BASHKIAK	KRYETARI I QARKUT	PREFEKTI	ADMINISTRATORI I NJËSISË
ASNJËHERË	56%	69,1%	89,3%	89,3%	59,8%
NJË HERË	15,9%	11,3%	1,9%	2,5%	11,9%
DY HERË	7,4%	5,6%	1%	0,4%	3,9%
TRE HERË	4,2%	2,8%	0,6%	0,2%	3,8%
KATËR HERË	2,4%	1,9%	0,2%	0,4%	2,5%
MBI KATËR HERË	13,1%	8,5%	1%	0,5%	14,4%
PA PËRGJIGJE	1%	0,8%	5,9%	6,7%	3,8%

Në pyetjen adresuar rreth periodicitetit të takimeve të qytetarëve me këshilltarët e bashkive, duke i specifikuar përgjigjet sipas bashkive, përgjigjet janë të renditura si më poshtë: kategoria më “popullore” është opsioni “asnjëherë”. Qytetarët e bashkisë Vorë bëjnë diferencën me rreth 43% të qytetarëve që deklarojnë se nuk kanë pasur asnjëherë takim me një këshilltar bashkiak. Më pas vijnë bashkia Kavajë e Rrogozhinë, ku qytetarët përgjigjen në kuotën 68% se nuk kanë pasur asnjëherë takim me këshilltarë bashkiakë. Bashkia Tiranë dhe Kamëz kanë kuota thuhet të njëjta, me 75%-78% të qytetarëve që nuk kanë pasur asnjë takim me këshilltarët. Kuota më e lartë është shënuar në Tiranën rurale, ish komunat, ku 84% deklarojnë se nuk kanë pasur asnjëherë takim me një këshilltar bashkiak. Në kategorinë maksimale, “mbi katër herë”, kuotat më të larta janë për banorët e bashkisë Vorë me 24%, ndjekur nga bashkia Kavajë me 11%, bashkia Rrogozhinë me 9%. Të dhënat e bashkisë Tiranë dhe Kamëz janë minimale, 0% deri 2%.

SA HERË JANË TAKUAR PËR PROBLEME/ÇËSHTJE TË NDRYSHME ME KËSHILLTARË BASHKIAKË						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
ASNJËHERË	75%	68,3%	84%	68,9%	78%	42,9%
NJË HERË	16,4%	13,3%	8,4%	6,7%	15%	5,4%
DY HERË	3,6%	3,3%	4,2%	5,9%	3%	12,9%
TRE HERË	0,9%	1,7%	1,7%	4,2%	0	8,2%
KATËR HERË	0,9%	1,7%	0	4,2%	0	4,8%
MBI KATËR HERË	1,8%	11,7%	1,7%	9,2%	3%	24,5%

PA PËRGJIGJE	1,4%	0	0	0,8%	1%	1,4%
--------------	------	---	---	------	----	------

SA HERË JANË TAKUAR PËR PROBLEME/ÇËSHTJE TË NDRYSHME ME KRYETARIN E BASHKISË						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
ASNJËHERË	68,2%	56,7%	74,8%	73,1%	45%	15,6%
NJË HERË	20%	15,8%	9,2%	10,9%	31%	8,8%
DY HERË	5%	5%	8,4%	2,5%	10%	14,3%
TRE HERË	3,2%	3,3%	2,5%	3,4%	4%	8,8%
KATËR HERË	0	0,8%	0	3,4%	3%	8,2%
MBI KATËR HERË	2,7%	18,3%	4,2%	5,9%	6%	42,2%
PA PËRGJIGJE	0,9%	0	0,8%	0,8%	1%	2%

SA HERË JANË TAKUAR PËR PROBLEME/ÇËSHTJE TË NDRYSHME ME KRYETARIN E QARKUT						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
ASNJËHERË	94,5%	95%	90,8%	86,6%	95%	74,1%
NJË HERË	2,3%	1,7%	2,5%	0	2%	2,7%
DY HERË	0	0	1,7%	0,8%	1%	2,7%
TRE HERË	0,5%	0	0	1,7%	0	1,4%
KATËR HERË	0	0	0	0,8%	1%	0
MBI KATËR HERË	0,9%	2,5%	0,8%	1,7%	0	0
PA PËRGJIGJE	1,8%	0,8%	4,2%	8,4%	1%	19%


SA HERË JANË TAKUAR PËR PROBLEME/ÇËSHTJE TË NDRYSHME ME PREFEKTIN						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
ASNJËHERË	95,9%	95,8%	88,2%	84,9%	93%	76,2%
NJË HERË	1,4%	2,5%	4,2%	1,7%	4%	2,7%
DY HERË	0,5%	0	0	0,8%	1%	0
TRE HERË	0	0	0	0	0	1,4%
KATËR HERË	0	0	0,8%	1,7%	0	0
MBI KATËR HERË	0	0,8%	1,7%	0,8%	0	0
PA PËRGJIGJE	2,3%	0,8%	5%	10,1%	2%	19,7%

SA HERË JANË TAKUAR PËR PROBLEME TË NDRYSHME ME ADMINISTRATORIN E NNJËSISË						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
ASNJËHERË	57,3%	61,7%	55,5%	73,9%	75%	43,5%
NJË HERË	25%	9,2%	9,2%	5%	9%	4,1%
DY HERË	5,9%	5%	1,7%	3,4%	2%	3,4%
TRE HERË	4,1%	2,5%	7,6%	1,7%	1%	4,8%
KATËR HERË	1,4%	0,8%	5,9%	0,8%	2%	4,8%
MBI KATËR HERË	4,1%	15,8%	20,2%	10,1%	9%	31,3%
PA PËRGJIGJE	2,3%	5%	0	5%	2%	8,2%

5.13. CILI ËSHTË RAPORTI I KËSHILLTARËVE MIDIS INTERESA PERSONALE DHE INTERESAVE QYTETARE?

Një set pyetjesh adresuar qytetarëve në pesë bashkitë e qarkut Tiranë kishin të bënin me qeverisjen vendore dhe raportet e saj me qeverisjen qendrore, si dhe me perceptimin publik mbi punën e bërë nga pushteti vendor gjatë mandatit aktual. Qytetarët u pyetën nëse mendonin se këshilltarët bashkiakë, në vend që të mendonin për interesat dhe nevojat e qytetarëve, mendonin e punonin për interesat e tyre personale. Në përgjigjet e dhëna në nivel qarku, rezultoi se më shumë se gjysma e qytetarëve mendonin se ky përcaktim kritik është i vërtetë. Konkretisht, 50.8% mendojnë se janë plotësisht dakord me përcaktimin, 15% janë mjaftueshëm dakord dhe vetëm 14% janë pak ose aspak dakord me këtë përcaktim.

NË VEND QË TË MENDOJNË PËR INTERESAT DHE NEVOJAT E QYTETARËVE TË THJESHTË KËSHILLTARËT MENDOJNË E PUNOJNË INTERESAT E TYRE PERSONALE




Në vlerësimin në rrafsh krahasimor midis pesë bashkive të qarkut, rezultoi se qytetarët më të pakënaqur me këshilltarët e tyre janë ata të Kavajës (66%), të Rrogozhinës (64%) dhe të Kamzës (47%). Banorët e zonës urbane në Tiranë dhanë vlerësim negativ (plotësisht dakord me përcaktimin kritik) në masën 47% dhe ata në zonat rurale në masën 52%. Kuota pozitive shënoi vetëm rasti i bashkisë Vorë, ku vetëm rreth një e katërta e qytetarëve të anketuar ishin dakord me përcaktimin kritik. Edhe në vlerësimin “pak dakord” ose “aspak dakord” Vora ka shifër rekord me mbi 20%, ndjekur nga zona rurale e Tiranës me 14%, kurse katër bashkitë, - Tirana urbane, Kavaja, Rrogozhina e Kamza kanë pothuajse të njëjtën kuotë vlerësimi nga 10% në 11%.

NË VEND QË TË MENDOJNË PËR INTERESAT DHE NEVOJAT E QYTETARËVE TË THJESHTË KËSHILLTARËT MENDOJNË E PUNOJNË INTERESAT E TYRE PERSONALE

PËRGJIGJET	TIRANË	KAVAJË	T-RURALE	RROGOZHINË	KAMËZ	VORË
Plotësisht dakord	47,7%	66,7%	52,9%	64,7%	60%	23,1%
Mjaftueshëm dakord	14,5%	15%	17,6%	13,4%	19%	15%
Pjesërisht dakord	25,9%	8,3%	11,8%	10,9%	10%	29,3%
Pak dakord	7,7%	7,5%	5%	4,2%	3%	22,4%
Aspak dakord	3,6%	2,5%	9,2%	5%	8%	8,2%
Pa përgjigje	0,5%	0	3,4%	1,7%	0	2%

5.14. SA APLIKOHET PËRFSHIRJA NË VENDIMMARRJET LOKALE?

Në vlerësimin se me reformën e re territoriale qytetarët janë përfshirë më shumë në vendimmarrjen në qeverisjen qendrore, në nivel qarku, më shumë se një e treta e të anketuarve janë kategorish kundër. Kategoritë “aspak” dhe “pak” dakord kanë së bashku mbi 60% të mbështetjes nga qytetarët, kurse kategoritë miratuese, plotësisht e mjaftueshëm dakord kanë respektivisht rreth 7% dhe 12%. Këto përfundime tregojnë se në tërësi qytetarët kanë qëndrime kritike në raport me sistemin e vendimmarrjes vendore dhe rolin e tyre si qytetarë në vendimmarrjet që lidhen me të.




Në krahasimin midis bashkive të qarkut Tiranë, rezulton se “plotësisht dakord” janë rreth 12% e banorëve të pyetur në zonën e bashkisë Vorë dhe në zonat rurale të Tiranës.

Në Tiranën urbane përqindja mbështetëse është mbi dy herë më e vogël, vetëm 5%, krahasueshëm me përgjigjet e dhëna edhe nga qytetarët e Rrogozhinës. Kurse përgjigjet e dhëna nga qytetarët e Kavajës dhe të Kamzës janë shumë më kritikë, me vetëm 2% dhe 3% pohim pozitiv për rolin e qytetarëve në vendimmarrjet lokale.

QYTETARËT PËRFSHIHEN NË VENDIMMARRJE NË QEVERISJEN VENDORE						
PËRGJIGJET	TIRANË	KAVAJË	T-RURALE	RROGOZHINË	KAMËZ	VORË
Plotësisht dakord	5%	2,5%	11,8%	5,9%	3%	12,2%
Mjaftueshëm dakord	10,9%	10%	7,6%	7,6%	9%	25,9%
Pjesërisht dakord	23,2%	22,5%	10,9%	13,4%	22%	19%
Pak dakord	28,6%	23,3%	26,9%	14,3%	26%	27,2%
Aspak dakord	31,4%	39,1%	39,5%	52,9%	40%	13,6%
Pa përgjigje	0,9%	2,5%	3,4%	5,9%	0	2%

5.15. SA JANË MBAJTUR PREMTIMET NGA BASHKIA?

Qytetarët u pyetën nëse ishin dakord me pohimin se me reformën e re territoriale dhe mandatin aktual qeverisës në pushtetin vendor, janë mbajtur premtimet e dhëna gjatë fushatës për zonën specifike ku ata banojnë. Në nivel qarku vetëm 8.7% konfirmojnë se janë mbajtur premtimet, 11% e quajnë mjaftueshëm bilancin e realizimit të premtimeve, kurse kategoritë negative, pak dhe aspak dakord kanë respektivisht mbështetjen kryesore me 19% dhe 36% e të gjithë të anketuarve. Duke lidhur këtë përgjigje me ato të dhëna më lart për mosnjohjen sa duhet të këshilltarëve apo me perceptimin kritik publik ndaj punës së tyre, është e pritshme që edhe vlerësimi tek mbajtja e premtimeve të jetë në kuota kritike.




Në analizën e pesë bashkive të qarkut Tiranë lidhur me bilancin e mbajtjes së premtimeve të dhëna në fushatë elektorale nga të zgjedhurit vendorë, ka diferenca të theksuara midis përgjigjeve të ardhura nga banorët rezident të bashkive.

JANË MBAJTUR PREMTIMET E DHËNA GJATË FUSHATËS LOKALE 2015 NË ZONËN TUAJ	TIRANË	KAVAJË	T-RURALE	RROGOZHINË	KAMËZ	VORË
PËRGJIGJET						
Plotësisht dakord	10,5%	3,3%	4,2%	8,4%	1%	19,7%
Mjaftueshëm dakord	11,4%	5,8%	6,7%	10,1%	7%	21,8%
Pjesërisht dakord	28,2%	17,5%	13,4%	22,7%	25%	23,8%
Pak dakord	19,1%	22,5%	23,5%	11,8%	16%	21,8%
Aspak dakord	29,5%	48,3%	51,3%	43,7%	51%	11,6%
Pa përgjigje	1,4%	2,5%	0,8%	3,4%	0	1,4%

Konkretisht, Vora ka përqindjen më të lartë miratuese me 19% ndjekur nga Tirana urbane me 10%, por njësitë e tjera kanë përqindje minimale miratuese, nga 8% në Rrogozhinë, 3% në Kavajë deri në 1% në rastin e bashkisë Kamëz. Edhe në vlerësimin më kritik, se nuk janë aspak dakord me këtë përcaktim, Vora ka përqindjen më të ulët, 11%, kurse bashkitë e tjera luhaten midis 30% (Tirana) deri në 51% (Kamza).

5.16. MATJA E PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMEVE BASHKIAKE

Një nga premtimet kryesore të reformës së re territoriale kishte të bënte me ofrimin më cilësor të shërbimeve tek qytetarët. Qytetarët u pyetën nëse janë dakord se reforma dhe përvoja e deritanishme e kanë përmbushur këtë premtim. Nga përgjigjet e dhëna në nivel qarku rezultoi se 28% nuk janë aspak dakord me vlerësimin, 17% janë pak dakord, 21% janë pjesërisht dakord, dhe se plotësisht dakord janë vetëm 12% e qytetarëve të anketuar.



E njëjta pyetje u analizua edhe nga përgjigjet e ardhura për secilën bashki më vete brenda qarkut Tiranë. Mbi bazën e përfundimeve rezultoi se në cilësimin “plotësisht dakord” qytetarët më vlerësues janë ata të bashkisë Vorë me 25.9%, ndjekur nga qytetarët e Tiranës dhe të Rrogozhinës me pothuajse gjysmën e këtij numri, 12%-13%.


ËSHTË PËRMIRËSUAR CILËSIA E SHËRBIMEVE BASHKIAKE

PËRGJIGJET	TIRANË	KAVAJË	T-RURALE	RROGOZHINË	KAMËZ	VORË
Plotësisht dakord	13,6%	6,7%	5%	12,6%	7%	25,9%
Mjaftueshëm dakord	23,2%	9,2%	11,8%	10,9%	15%	24,5%
Pjesërisht dakord	26,4%	18,3%	24,4%	16%	15%	23,8%
Pak dakord	13,2%	22,5%	23,5%	13,4%	19%	14,3%
Aspak dakord	18,2%	41,7%	31,1%	44,5%	44%	8,2%
Pa përgjigje	5,5%	1,7%	4,2%	2,5%	0	3,4%

Qytetarët e Kavajës dhe të Kamzës kanë pothuajse të njëjtin vlerësim kritik, midis 6% dhe 7%, kurse qytetarët e zonave rurale të Tiranës janë edhe më kritikë, me vetëm 5%. Në përgjigjet kritike ndaj këtij përcaktimi, “pak” dhe “aspak dakord” qytetarët e Kavajës dhe të Kamzës kanë kuotat më të larta me mbi 63%, qytetarët e Rrogozhinës dhe zonave rurale në Tiranë kanë përqindje të përafërt me rreth 55%-57%, qytetarët e Tiranës kanë vlerësim 31% dhe në fund, me vlerësimin më minimal negativ janë qytetarët e bashkisë Vorë me vetëm 22%.

5.17. VLERËSIMI MBI CILËSINË E JETËS PAS MANDATIT TË PARË

Qytetarët u pyetën nëse pas 3 vitesh qeverisje lokale me sistemin e ri administrativ, jeta e tyre ishte më e mirë sesa përpara kësaj reforme dhe këtij përfaqësimi. Në nivel qarku, 35% deklaruan se nuk shohin asnjë përmirësim pozitiv në jetën e tyre, nga 20% e qytetarëve ishin pak ose pjesërisht dakord me këtë vlerësim dhe se plotësisht dakord ishin vetëm 10% e qytetarëve. Kurba e vlerësimit kritik është e njëjtë në të gjithë treguesit, ndaj edhe vlerësimi për nivelin e jetesës midis dy periudhave shkon në këtë trend perceptimi publik.



Në nivelin krahasimor të bashkive rezulton se qytetarët më të kënaqur me progresin 3 vjeçar të jetës së tyre me sistemin e ri administrativ janë qytetarët e Vorës (18.4%), ndjekur nga qytetarët e Tiranës urbane (12.7%) dhe ata të Rrogozhinës (11.8%), tri bashki që zgjeruan territorin dhe patën zhvillim më të madh me ndarjen e re administrative.

Qytetarët më kritikë janë ata të Kamzës me vetëm 2% vlerësim pozitiv, ndjekur nga qytetarët e zonave rurale të Tiranës me 3.4% dhe ata të Kavajës me 6.7%. Edhe kategoria e vlerësimit “pak” dhe “aspak” dakord ruan të njëjtin trend, - me qytetarët e Vorës që janë dukshëm më optimistë dhe vlerësues sesa banorët e bashkive të tjera të qarkut Tiranë.

JETESA JUAJ ËSHTË MË E MIRË SE TRE VITE MË PARË


PËRGJIGJET	TIRANË	KAVAJË	T-RURALE	RROGOZHINË	KAMËZ	VORË
Plotësisht dakord	12,7%	6,7%	3,4%	11,8%	2%	18,4%
Mjaftueshëm dakord	11,8%	4,2%	8,4%	8,4%	9%	25,9%
Pjesërisht dakord	20,5%	15,8%	25,2%	21,8%	15%	23,1%
Pak dakord	25%	25%	18,5%	9,2%	22%	18,4%
Aspak dakord	29,5%	45,8%	42%	46,2%	51%	12,2%
Pa përgjigje	0,5%	2,5%	2,5%	2,5%	1%	2%

5.18. BILANCI I EFIKASITETIT TË PUNËS SË BASHKISË

Në vlerësimin e përgjithshëm nëse ndarja e re territoriale e ka përmirësuar punën e bashkisë në dobi të qytetarëve, në nivel qarku, vlerësimi i qytetarëve është në tërësi kritik, - me 34% që janë tërësisht kritikë, 17% pak kritikë, etj.

Numri i qytetarëve që është plotësisht dakord është vetëm 6%, një shifër shumë e vogël në raport me mbështetjen e madhe që pati ndarja e re territoriale në vitet 2014-2015 dhe sistemi i ri i përfaqësimit politik vendor. Në këtë pyetje bën përshtypje edhe numri i lartë i qytetarëve që nuk janë dhënë përgjigje të qartë ose kanë refuzuar të ketë një vlerësim për nën kategoritë e testit, mbi 15% e tyre.

NDARJA E RE TERRITORIALE E KA PËRMIRËSUAR PUNËN E BASHKISË NË DOBI TË QYTETARËVE



E njëjta pyetje në nivelin krahasimor të bashkive të qarkut Tiranë krijon diferenca vlerësimi midis vetë bashkive. Koncretisht, në këtë kategorizim qytetarët e bashkisë Rrogozhinë dhe Tiranë janë më konfirmues dhe më mbështetës me përkatësisht 12% dhe 9%.

Në Kamëz e Vorë rezultati mbështetës është rreth 4% kurse në Kavajë 2.5% e në zonat periferike të Tiranës shifër rekord negative me vetëm 1.7% të mbështetjes ndaj vlerësimit pozitiv për ndarjen e re territoriale dhe rolit të bashkisë së re në shërbim të qytetarëve.


NDARJA E RE TERRITORIALE E KA PËRMIRËSUAR PUNËN E BASHKISË NË DOBI TË QYTETARËVE

PËRGJIGJET	TIRANË	KAVAJË	T-RURALE	RROGOZHINË	KAMËZ	VORË
Plotësisht dakord	9,1%	2,5%	1,7%	12,6%	4%	4,8%
Mjaftueshëm dakord	16,4%	5%	5%	9,2%	7%	21,8%
Pjesërisht dakord	20,5%	10%	7,6%	11,8%	11%	17%
Pak dakord	15,9%	20,8%	24,4%	8,4%	20%	19,7%
Aspak dakord	17,7%	50%	43,7%	45,4%	45%	22,4%
Pa përgjigje	20,5%	11,7%	17,6%	12,6%	13%	14,3%

5.19. BILANCI I REFORMËS DHE SHËRBIMET PUBLIKE

Në përcaktimin nëse ndarja e re territoriale ka përmirësuar shërbimet publike në nivel qarku, rreth një e treta e të anketuarve nuk janë aspak dakord, dhe vetëm 7% janë tërësisht dakord. Secila prej nën kategorive të tjera alternative ka mbështetje por një krahasim midis pjesës kritike dhe konfirmuese kjo e fundit rezulton të jetë shumëfish më e vogël sesa kritika. Edhe në këtë rast rreth 15% nuk kanë qenë në gjendje të kenë një vlerësim të qartë mbi alternativat ose nuk kanë dashur të shprehen edhe për shkak se pyetja ka të bëjë me një vlerësim të zgjeruar të shërbimeve dhe jo me një temë specifike dhe lehtësisht të identifikueshme.

NDARJA E RE TERRITORIALE KA PËRMIRËSUAR SHËRBIMET PUBLIKE




Edhe në nivelin e bashkive brenda qarkut, ruhet trendi i vlerësimit kolektiv, me specifika të veçanta. Konkretisht banorët e Rrogozhinës janë më vlerësues në aspektin e efektit në përmirësimin e shërbimeve publike, me mbi 12%, ndjekur nga banorët e Tiranës urbane 9% dhe ata të Vorës 8%.

Niveli më i ulët i vlerësimit pozitiv është shënuar në Kavajë me 2.5%, ndjekur nga Tirana rurale me 3.4% dhe më pas Kamza me 4%. Në përgjigjen se nuk janë aspak dakord me këtë vlerësim banorët e Tiranës urbane janë më pozitivistë me 19% ndjekur nga banorët e Vorës me 22%, kurse banorët e Kavajës dhe të Kamzës janë më kundërshtuesit me përkatësisht 50% dhe 46% të të anketuarve.

NDARJA E RE TERRITORIALE KA PËRMIRËSUAR SHËRBIMET PUBLIKE						
PËRGJIGJET	TIRANË	KAVAJË	T-RURALE	RROGOZHINË	KAMËZ	VORË
Plotësisht dakord	9,1%	2,5%	3,4%	12,6%	4%	8,8%
Mjaftueshëm dakord	15,5%	5,8%	6,7%	11,8%	3%	15%
Pjesërisht dakord	23,2%	10%	8,4%	10,9%	7%	20,4%
Pak dakord	15%	20%	26,1%	10,1%	25%	17,7%
Aspak dakord	19,1%	50%	38,7%	40,3%	46%	22,4%
Pa përgjigje	18,2%	11,7%	16,8%	14,3%	15%	15,6%

5.20. AKSESI PËR TË ADRESUAR ANKESA / KËRKESA

Banorët e qarkut Tiranë u pyetën edhe nëse me sistemin e ri administrativ dhe qeverisjen e re lokale është bërë më e thjeshtë për të drejtuar një ankesë apo kërkesë autoriteteve vendore. Kjo është e vetmja pyetje ku ka përgjigje të balancuara në nivel qarku. Konkretisht vetëm një e katërta e banorëve nuk janë aspak dakord me këtë përcaktim dhe se mbi 15% janë dakord, kurse në kategoritë e tjera të përgjigjeve kemi vlerësime gati të njëjta me 12% ose 14%, si dhe me vlerësimin pjesërisht dakord të 18% të banorëve të anketuar.



Në nivel bashkish brenda qarkut Tiranë gjithashtu ka balancë dhe vlerësim proporcional, ndryshe nga përgjigjet e pyetjeve të tjera. Konkretisht, plotësisht dakord me këtë përcaktim janë rreth 8% e qytetarëve në Kavajë e Kamëz dhe rreth 20% në Tiranën urbane dhe në Vorë. Pjesa e Tiranës rurale dhe e Rrogozhinës ka gjithashtu afërsi në vlerësim me rreth 14%-15% të përgjigjeve vlerësuese.

Në kategorinë e përgjigjeve negative, ka diferencë të madhe midis perceptimit të banorëve të bashkive të qarkut. Konkretisht vetëm 8% e banorëve të Tiranës urbane dhe dyfish më shumë në Vorë nuk janë aspak dakord me përcaktimin. Në bashkitë e tjera përgjigjet marrin nga rreth 40% në Kavajë, Kamzës e Rrogozhinë në 27% në zonat rurale të Tiranës.

ËSHTË BËRË MË E THJESHTË TË DREJTOSH NJË ANKESË / KËRKESË

PËRGJIGJET	TIRANË	KAVAJË	T-RURALE	RROGOZHINË	KAMËZ	VORË
Plotësisht dakord	21,8%	7,5%	13,4%	15,1%	8%	19,7%
Mjaftueshëm dakord	16,4%	5,8%	15,1%	9,2%	10%	14,3%
Pjesërisht dakord	25,9%	18,3%	10,9%	8,4%	15%	23,1%
Pak dakord	8,6%	18,3%	17,6%	8,4%	17%	18,4%
Aspak dakord	8,6%	42,5%	27,7%	37%	39%	16,3%
Pa përgjigje	18,6%	7,5%	15,1%	21,8%	11%	8,2%


5.21. PUSHTETI VENDOR VS PUSHTETI QËNDROR: CILI KA MË SHUMË KOMPETENCA?

Qytetarët u pyetën të thonë një vlerësim të tyre personal për sistemin dhe efikasitetin e qeverisjes vendore në zonën ku ata banojnë. Midis 133 varianteve të ndryshme të përgjigjeve, ato me numrin më të madh të qytetarëve mbështetës janë vlerësimet se “ka punuar mirë, por ka shumë për të bërë” me 16%, “aspak funksionale, e dobët” me 6%, “kanë punuar mjaftueshëm” me 5%, “ka shumë për përmirësime” me 2%, “janë të korruptuar e të paaftë” me 2%, “më shumë fjalë sesa punë” me 1.9%, etj. Pjesa tjetër e përgjigjeve ishte nën kuotat 2% dhe lidhet me interpretime të ndryshme, të cilat është e vështirë të përmbledhen në kategori për të arritur në një vlerësim krahasues.

Duke analizuar raportet midis pushtetit qendror dhe pushtetit vendor si dhe perceptimit qytetar mbi to, pjesë e anketimit u bënë edhe pyetjet që lidhen me kompetencat aktuale midis dy pushteteve dhe mbi dëshirën e vetë qytetarëve se cili prej pushteteve duhet të ketë më shumë kompetenca.

Në pyetjen e parë që lidhet me pyetjen “midis pushtetit vendor dhe qendror, cili mendoni se ka më shumë kompetenca për gjërat që lidhen me jetën/punën tuaj”, përgjigjia tregon se 47% e qytetarëve mendojnë se pushteti lokal ka më shumë kompetenca, ndaj 43% që mendojnë se kompetencat janë të pushtetit qendror. Diferenca midis dy alternativave, pushtet vendor dhe qendror është rreth 4%, kurse numri i personave që mendojnë se zgjidhje më e mirë është ndërthurja e kompetenca është minimal, me vetëm 1,4% mbështetje.

**CILI PUSHTET KA MË SHUMË KOMPETENCA PËR GJËRAT QË
LIDHEN ME JETËN/PUNËN TUAJ?**



Në analizën sipas bashkive të qarkut Tiranë, mbështetjen më të madhe pushtetit vendor për shërbimet ndaj qytetarëve ia japin banorët e zonave rurale, kryesisht Tirana rurale me 68% dhe ata të Vorës me 63%. Banorët e Kavajës janë më të balancuar në ndarjen e kompetencave midis dy pushteteve, kurse interesant është fakti se banorët e Tiranës urbane janë dukshëm në favor të pushtetit qendror, dhe me tendencë të njëjtë edhe banorët e Rrogozhinës dhe të Kamzës.


CILI PUSHTET KA MË SHUMË KOMPETENCA PËR GJËRAT QË LIDHEN ME JETËN TUAJ?

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pushtetit lokal	33,2%	50,8%	68,1%	37,8%	41%	63,3%
Pushteti qendror	55,9%	44,2%	29,4%	47,9%	47%	30,6%
Pa përgjigje	6,4%	3,3%	0,8%	13,4%	9%	2,7%
Tjetër	4,7%	1,7%	1,6%	0,8%	3%	3,4%

5.22. USHTRIMI I PUSHTETIT DHE PRITSHMËRIA PËR TË ARDHMEN

Në pyetjen se cili prej pushteteve duhet të ketë më shumë kompetenca në të ardhmen, shumica absolute e përgjigjeve në nivel qarku i japin prioritet qeverisjes lokale. Konkretisht 76% janë mbështetës për qeverisjen lokale dhe vetëm 17% janë për më shumë kompetenca në qeverisjen qendrore. Ky përfundim mund të lidhet edhe me faktin se në perceptimin qytetar shërbimet bazë gjenden në njësitë vendore (bashki, njësi, qark) ndaj edhe qytetarët janë të prirur t'i marrin ato në nivel lokal, ndërkohë që qeveria qendrore konsiderohet larg nevojës dhe kërkesave të përditshme qytetare.

CILI PUSHTET DUHET TË KETË MË SHUMË KOMPETENCA?



Edhe në vlerësimin në nivel krahasues të bashkive, rezulton se pushteti vendor merr mbështetje absolute në Kavajë (96%) dhe mbështetje shumë të lartë në Vorë (86%), Tirana rurale (76%), Rrogozhinë (73%), kurse Tirana urbane dhe Kamza kanë të njëjtin nivel vlerësimi, me 65%.

Kuotat më të larta në favor të pushtetit qendror i ka dhënë Kamza me 26%, ndjekur nga Tirana urbane me 24% dhe se kuotat më të vogla mbështetëse për pushtetin vendor i ka dhënë Kavaja me 3.3%. Shpjegimi në rastin e Tiranës urbane mund të lidhet me faktin se këtu ndodhen të gjitha godinat qeveritare dhe vendimmarrëse, ndaj edhe ata janë përfitues direkt të vendimmarrjeve të tyre, gjë që nuk ndodh me zonat rurale.

CILI PUSHTET DUHET TË KETË MË SHUMË KOMPETENCA?

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pushtetit lokal	65,9%	96,7%	76,5%	73,1%	65%	86,4%
Pushteti qendror	24,5%	3,3%	17,6%	18,5%	26%	8,8%
Pa përgjigje	7,3%	0	4,2%	8,4%	4%	3,4%
Tjetër	2,5%	0	1,6%	0	5%	1,4%

5.23. KËRKESAT PRIORITARE TË QYTETARËVE PËR VITIN 2019

Qytetarët u pyetën të identifikojnë sipas rëndësisë, tri problematikat kryesore që ata kanë dhe që duan të marrin zgjidhje në mandatin e ardhshëm të qeverisjes vendore. Në nivel qarku përgjigjet janë si më poshtë: Problematikat kryesore mbeten ato që përbëjnë edhe fokusin kryesor të pushtetit vendor, investimet në rrugë e infrastrukturë, punësimi, furnizimi me ujë, ndriçimi, kanalizimet, taksat, arsimit, shërbimet e pastrimit, etj. Rrugët dhe punësimi kryesojnë prioritetin e parë, uji dhe rrugët prioritetin e dytë dhe punësimi e ndriçimi prioritetin e tretë. Në tërësi qytetarët dhanë 165 variante të ndryshme

propozimesh si problematikë e parë, 142 si problematikë e dytë dhe 84 si problematikë e tretë prioritare në nivel qarku.

3 PROBLEMATIKAT PRIORITARE PER ZGJIDHJE NE MANDATIN E ARSHSHEM					
PROBLEMI I PARË		PROBLEMI I DYTË		PROBLEMI I TRETË	
Rrugët	13,9%	Ujë	8%	Punësimi	4,2%
Punësimi	9,7%	Rrugë	6,4%	Ndriçimi	2,8%
Furnizimi me ujë	9%	Ndriçimi	4,9%	Furnizimi me ujë	2,8%
Infrastruktura	4,5%	Papunësia	4,5%	Rrugët	1,8%
Ndriçimi	2,8%	Kanalizimet	3,4%	Taksa	1,7%
Kanalizimet	2,4%	Pastrimi	3,2%	Gjelbërimi	1,6%
Taksat	1,9%	Taksat	2,3%	Kanalizimet	1,6%
Arsimi	1,7%	Gjelbërimi	1,8%	Pastrimi i vëndit	1,4%
Transporti publik	1,3%	Infrastruktura	1,5%	Zhurmat	1,3%
Pastrimi	1,2%	Arsimi	1,4%	Arsimi	1,3%

Në bashkinë Tiranë (zona urbane) qytetarët evidentuan si problem të parë 73 problematika, të cilat do të donin të merrnin zgjidhje në mandatin e ardhshëm. Problematikat më të kuotuar janë çështjet e papunësisë (19%), rrugët dhe trotuaret (7%), infrastruktura (6%), furnizimi me ujë të pijshëm dhe taksat e larta (rreth 3.7%), trafiku (2.7%), ndotja akustike (2.6%), pastrimi (2.5%) dhe transporti publik (2.3%). Secila nga 74 problematikat e tjera të listuara nga qytetarët ka mbështetje më të vogël totale, ose përbëjnë aspekte të ndryshme të problematikave të mësipërme.

PROBLEMI I PARË NË BASHKINË TIRANË	PËRQINDJE
Papunësia	19,3%
Rruga, trotuare, rrugica	7%
Infrastruktura	6,4%
Ujë i pijshëm 24 orë	3,8%
Taksat e larta	3,6%
Trafiku	2,7%
Ndotja akustike	2,6%
Pastrimi	2,5%
Transporti publik	2,3%

Qytetarët e Kavajës evidentuan 25 problematika prioritare që do të donin të merrnin zgjidhje në mandatin e ardhshëm të qeverisjes vendore në këtë bashki. Në listën prioritare bëjnë pjesë problematikat me rrugët (23%), furnizimi me ujë (14%), papunësia (6.6%), kanalizimet (3.3%), ndryshimi, dritat elektrike, ulja e taksave dhe depozitat e ujit. Pjesa tjetër e alternativave ishte formë tjetër e shprehjes së këtyre problematikave, ose probleme specifike të secilës zonë në anketim, por që në totalin si bashki nuk morën përqindje më të lartë sesa kategoritë e listuara prioritare.

PROBLEMI I PARË NË BASHKINË KAVAJË	PËRQINDJE
Rruga	23,9%
Furnizimi me ujë	14,1%
Pastrim	6,6%

Papunësia	4,2%
Kanalizimet	3,3%
Ndriçimi	2,5%
Drita elektrike	1,7%
Ulja e taksave	1,7%
Depozitat e ujit	0,8%

Në zonën rurale të Tiranës u regjistruan 28 problematika prioritare, të cilat qytetarët e anketuar mendojnë se duhet të marrin zgjidhje emergjente në mandatin e ardhshëm. Konkretisht, në listën prioritare të tyre janë problemet me rrugët (34%), dukshëm në diferencë me problematikat e tjera. Më tej listohen problemet e furnizimit me ujë (8%), shkollat (7%), infrastruktura lokale (5%), papunësia (5%), transporti publik (4%), shërbimi i urbanëve (3%), problemet e ndriçimit, pronat, taksat dhe uji për vaditje. Problematikat e tjera janë formë tjetër e shprehjes së të njëjtave problematika ose çështje që kanë të bëjnë me komunitete të caktuara lokale.

PROBLEMI I PARË NË BASHKINË T - RURALE	PËRQINDJE
Rruga (nacionale, lagje, fshati, trotuare etj.)	34,1%
Furnizimi me ujë	8,3%
Shkolla	7,3%
Infrastruktura	5,8%
Papunësia	5,7%
Transporti publik	4,2%
Shërbimi i urbanëve	3,4%
Ndricimi	1,7%
Pronat	1,7%
Taksat	1,6%
Ujë për vaditje	1,6%

Në bashkinë Rrogozhinë u evidentuan 36 problematika, nga të cilat problematikat prioritare të qytetarëve të anketuar për zgjidhje në mandatin e ardhshëm ishin: problemi i rrugëve dhe trotuareve (27%), papunësia tek të rinjtë (12%), infrastruktura (8%), furnizimi me ujë (6%), energjia elektrike (4%), ndriçimi publik (4,2%), uji i pijshëm (3.4%), plehrat (2.5%), rrugët e fshatit (2.5%), kanalizimet (1.7%), etj.

PROBLEMI I PARË NË BASHKINË RROGOZHINË	PËRQINDJE
Rrugët, trotuaret	27,7%
Papunësia + te rinjve	12,4%
Infrastruktura	8,4%
Furnizimi me ujë	5,9%
Energjia elektrike	4,2%
Ndricimi publik	4,2%
Uji cilësor i pijshëm	3,4%

Plehrat	2,5%
Rrugët e fshatit	2,5%
Kanalizimet	1,7%

Në bashkinë Kamëz u listuan në total 39 problematika prioritare për trajtim e zgjidhje në mandatin e ardhshëm të bashkisë, bazuar në preferencat qytetare. Në këtë listë dominuese janë problematikat me furnizimin me ujë (13%), rrugët (11%), kanalizimet (8%), taksat e larta (7.5%), ndriçimi (7.2%), infrastruktura lokale (7.1%), , punësimi (4.4%), shërbimi urban (3.5%), shkolla me dy turne (2.5%), kushtet në ambientet shkollore (2.4%), etj.

PROBLEMI I PARË NË BASHKINË KAMËZ	PËRQINDJE
Furnizimi me ujë	13,1%
Rrugët	11%
Kanalizimet	8%
Taksat e larta	7,5%
Ndriçimi	7,2%
Infrastruktura	7,1%
Punesimi	4,4%
Shërbimi urban	3,5%
Shkolla me dy turne	2,5%
Arsimi (kushtet)	2,4%

Në bashkinë Vorë u listuan 29 problematika prioritare, të cilat qytetarët duan të trajtohen dhe të zgjidhen në mandatin e ardhshëm të drejtuesve të bashkisë. Koncretisht, në listë bëjnë pjesë ujësjellësi (12%), rrugët (7,5%), shkollat (4.4%), legalizimet (3.9%), ndriçimi (3.7%), papunësia (3.5%), infrastruktura dhe kanalizimet (3.4%), mbeturinat (3.3%), ndihma ekonomike (3.1%), ngrohja në shkolla (3.1%), etj.


PROBLEMI I PARË NË BASHKINË VORË	PËRQINDJE
Ujësjellsi	12,2%
Rrugët	7,2%
Shkollat (kushtet)	4,4%
Legalizimet	3,9%
Ndriçimi	3,7%
Papunësia	3,5%
Infrastruktura	3,4%
Kanalizimet	3,4%

6. BILANCI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE KRYESORE TË BASHKISË

Tri vite pas fillimit të mandatit aktual qeverisës në zgjedhjet vendore qytetarët kanë krijuar tashmë një perceptim paraprak për bilancin e aktivitetit të bashkive dhe kapacitetet e tyre në lidhje me funksionet bazë. Një pjesë e pyetësorit iu dedikua pikërisht këtyre raporteve, për të hulumtuar perceptimin qytetar mbi disa prej shërbimeve që janë edhe prioritet për qytetarët.

6.1. VLERËSIMI MBI SHËRBIMIN E PASTRIMIT OFRUAR NGA BASHKITË

Qytetarët u pyetën për shërbimet që ofrojnë bashkitë e reja. Ata u pyetën sesi e vlerësojnë shërbimin e pastrimit të territorit dhe mjediseve publike. Në nivel qarku 28% shprehën vlerësim pozitiv dhe 18% vlerësim negativ. Dominuese ishte vlerësimi mesatar për shërbimin e pastrimit me kuotë 31%. Numri i qytetarëve që nuk morën pjesë në anketim ose refuzuan të përgjigjen ishte shumë i vogël, një tregues se shërbimi i pastrimit është një prej shërbimeve me interes të gjerë të qytetarëve pavarësisht zonave ku ata banojnë.




Në nivel bashkish, rekord pozitiv është vlerësimi i qytetarëve të bashkisë Vorë, ku 53% e vlerësojnë pozitivisht shërbimin e pastrimit dhe vetëm 2.7% kanë vlerësim negativ. Më pas vjen Tirana urbane, ku 25% e qytetarëve kanë vlerësim pozitiv dhe vetëm 6.4% kanë vlerësim negativ për shërbimin e pastrimit. Në zonat rurale të Tiranës gjithashtu ka diferencë minimale pozitive, përkatësisht 23% me 22%. Në Kavajë diferenca midis dy vlerësimeve është në favor të vlerësimit negativ (me 8%), në Rrogozhinë diferenca midis dy vlerësimeve është vetëm 5% në favor të vlerësimit negativ, kurse në Kamëz diferenca është 22% në favor të vlerësimit negativ.

SHËRBIMI I PASTRIMIT PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pozitivisht	25,5%	22,5%	23,5%	24,4%	17%	53,1%
Pjesërisht pozitivisht	18,2%	8,3%	14,3%	10,9%	2%	8,8%
Nivel mesatar	43,2%	28,3%	30,3%	23,5%	21%	30,6%
Pjesërisht negativisht	6,4%	10%	8,4%	10,9%	18%	4,8%
Negativisht	6,4%	30%	22,7%	29,4%	39%	2,7%
Pa përgjigje	0,5%	0,8%	0,8%	0,8%	3%	0

6.2. VLERËSIMI MBI SHËRBIMET NË SISTEMIN PARASHKOLLOR OFRUAR NGA BASHKITË

Qytetarët u pyetën sesi e vlerësojnë shërbimin e bashkisë në çështjet e arsimit parashkollor. Nga përgjigjet rezultoi se në nivel qarku 31% kanë vlerësim se niveli i shërbimit të bashkisë ka qenë mesatar, 23% kanë vlerësim maksimal pozitiv dhe vetëm 8.7% kanë vlerësim maksimal negativ.

Dy opsionet e vlerësimeve pozitive marrin rreth 40% të mbështetjes, kurse dy opsionet e vlerësimeve negative marrin rreth 20%, pra dyfish më pak. Kjo është tregues se në tërësi në nivel qarku ka një pikëpamje të gjerë se bashkitë kanë balance pozitive në shërbimet e tyre në edukimin parashkollor.



Në rrafshin krahasimor të bashkive, rezultoi se vlerësimi pozitiv për funksionet e bashkisë në arsimin parashkollor është trend në katër nga pesë bashkitë, - në Tiranën urbane me 15% më shumë pozitive sesa negative, në Tiranën rurale me 20% plus, në Rrogozhinë me 6% plus, në Kamëz me 3% plus dhe në vore me diferencën më të madhe, me 28% plus midis vlerësimit pozitiv dhe negativ.


Në të vetmen bashki me vlerësim të ndryshëm nga trendi, Kavajë, kuotat e vlerësimit negativ në këtë funksion janë 5% më të mëdha sesa vlerësimi pozitiv.

EDUKIMI PARASHKOLLOR						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pozitivisht	20%	13,3%	26,9%	18,5%	16%	40,8%
Pjesërisht pozitivisht	18,6%	21,7%	11,8%	18,5%	7%	16,3%
Nivel mesatar	32,3%	29,2%	39,5%	30,3%	37%	24,5%
Pjesërisht negativisht	7,7%	14,2%	11,8%	6,7%	20%	12,9%
Negativisht	5,5%	18,3%	6,7%	12,6%	13%	1,4%
Pa përgjigje	15,9%	3,3%	3,4%	13,4%	7%	4,1%

6.3. VLERËSIMI MBI SHËRBIMIN VADITJE DHE KULLIM OFRUAR NGA BASHKITË

Në funksionin e vaditjes dhe të kullimit, aktivitete që janë me rëndësi të madhe për banorët e zonave rurale në qarkun Tiranë, vlerësimi i përgjithshëm në nivel qarku ishte dukshëm negativ, - 35.8% në raport me vlerësimin minimal pozitiv 8.7%. Edhe vlerësimet e tjera plotësuese negative, si pjesërisht negativ, kanë kuota dyfish më të larta sesa vlerësimi balancues pjesërisht pozitiv.

Për shkak edhe të specifikës rurale, numri i qytetarëve që nuk dhanë përgjigje ose nuk ishin në gjendje të jepnin një përgjigje të saktë, ishte i lartë, rreth 15%, kryesisht banorë të qendrave të mëdha urbane që nuk preken direkt nga problemet e vaditjes dhe të kullimit.




Në analizën për secilën bashki, rezultoi se me përjashtim të Tiranës urbane, ku perceptimi qytetar është më pozitiv sesa negativ, në të gjitha bashkitë e tjera ka perceptim dukshëm negativ, madje me kuota shumë të larta.

Konkretisht, në Kamëz e Kavajë diferenca midis vlerësimit negativ e pozitiv është përkatësisht 59% dhe 48% në favor të vlerësimit negativ, në Tiranën rurale gjithashtu diferenca është e lartë, 48%, në bashkinë Rrogozhinë diferenca është 23% dhe në bashkinë Vorë diferenca është 17%.

VADITJA DHE KULLIMI						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pozitivisht	10,5%	2,5%	7,6%	10,9%	2%	15%
Pjesërisht pozitivisht	10,5%	9,2%	4,2%	8,4%	2%	15%
Nivel mesatar	29,5%	5,8%	8,4%	17,6%	8%	10,2%
Pjesërisht negativisht	15,9%	20%	16,8%	8,4%	21%	17%
Negativisht	9,5%	50%	54,6%	33,6%	61%	32,7%
Pa përgjigje	24,1%	12,5%	8,4%	21%	6%	10,2%

6.4. VLERËSIMI MBI SHËRBIMIN NË TREGJE DHE ZHVILLIM OFRUAR NGA BASHKITË

Pjesë e matjeve ishte edhe vlerësimi për funksionet e bashkive në fushën e tregjeve dhe të zhvillimit social dhe ekonomik. Në nivel qarku, edhe në këtë pikë ka dukshëm perceptim kritik ndaj bilancit të punës së bashkive. Konkretisht, 34% e qytetarëve shprehin vlerësim negativ dhe 20% vlerësim pjesërisht negativ, ndërkohë që në anën tjetër, vetëm 7% japin vlerësim pozitiv dhe 9% vlerësim pjesërisht pozitiv. Në këtë rast, duke qenë shërbime që prekin si banorët e zonave urbane ata edhe të zonave rurale, numri i qytetarëve që nuk ka shprehur opinion është minimal, vetëm 3%.




Krahasimi midis bilancit dhe perceptimit të qytetarëve sipas bashkive në shërbimet e tregjeve dhe të zhvillimit, rezultoi se vetëm bashkia Vorë ka rezultate të balancuara midis vlerësimit negativ e pozitiv, me diferencë minimale prej 3% në favor të vlerësimit kritik. Në bashkitë e tjera dominuese janë vlerësimet negative dhe pjesërisht negative. Konkretisht në Tiranën urbane 11% janë më shumë kritikë, në Kavajë 41% janë kritikë, në Tiranën rurale 43% janë kritikë, në Rrogozhinë 37% janë kritikë dhe në Kamzës shënohet shifra më e lartë kritike, prej 48% e të anketuarve.

TREGJET DHE ZHVILLIMI						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pozitivisht	6,4%	3,3%	5%	7,6%	5%	16,3%
Pjesërisht pozitivisht	16,4%	6,7%	6,7%	9,2%	0	12,9%
Nivel mesatar	35,5%	25%	15,1%	20,2%	11%	23,8%
Pjesërisht negativisht	20,5%	20%	20,2%	11,8%	26%	25,9%
Negativisht	17,3%	44,2%	48,7%	43,7%	53%	19,7%
Pa përgjigje	4,1%	0,8%	4,2%	7,6%	5%	1,4%

6.5. VLERËSIMI MBI SHËRBIMIN UJËSJELLËS E KANALIZIME OFRUAR NGA BASHKITË

Qytetarët u pyetën lidhur me vlerësimin e tyre mbi funksionin e bashkisë në shërbimet e ujësjellësit dhe të kanalizimeve. Në nivel qarku përgjigjet negative ishin dyfish më të larta sesa përgjigjet pozitive, konkretisht, 28% me vlerësim negativ dhe 14% me vlerësim pozitiv. Në tërësi bashkimi i dy vlerësimeve pozitive dhe dy vlerësimeve negative anohet nga këto të fundit, në raportet 48% me 26%.



Në krahasimin e bashkive të qarkut Tiranë lidhur me shërbimet në ujësjellës dhe në kanalizime, rezultojnë se vlerësimin më të lartë pozitiv e japin qytetarët e bashkisë Vorë me 32%, në diferencë të madhe me bashkitë e tjera. Bashkia e dytë në radhë në vlerësimet pozitive është Tirana rurale dhe Rrogozhina me nga 13%, si dhe Tirana urbane me 11%.

Bashkitë me vlerësimin më minimal pozitiv janë Kavaja me 5% dhe Kamza me 6%. Në vlerësimin e skajshëm negativ nivelin më të lartë e kanë shprehur qytetarët e Kamzës me 46%, qytetarët e Kavajës me 40%, ndjekur nga qytetarët e Rrogozhinës dhe Tiranës rurale me nga 31%-34%. Dy bashkitë me rezultate më të ulta negative janë Vora me vetëm 6% dhe Tirana urbane me 22%.


UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMET						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pozitivisht	11,4%	5%	13,4%	13,4%	6%	32,7%
Pjesërisht pozitivisht	19,5%	9,2%	7,6%	9,2%	3%	19,7%
Nivel mesatar	23,6%	21,7%	16%	26,9%	25%	22,4%
Pjesërisht negativisht	22,3%	23,3%	28,6%	13,4%	17%	19%
Negativisht	22,7%	40,8%	31,9%	34,5%	46%	6,1%
Pa përgjigje	0,5%	0	2,5%	2,5%	3%	100%

6.6. VLERËSIMI MBI SHËRBIMIN GJELBËRIM DHE NDRIÇIM OFRUAR NGA BASHKITË

Në vlerësimin e cilësisë në shërbimet e gjelbërimit dhe të ndriçimit nga ana e bashkive, qytetarët e qarkut Tiranë në tërësi kanë dhënë vlerësime të balancuara, ku kategoritë e vlerësimit negativ dhe ato

të nivelit mesatar kanë të njëjtën kuotë 27%, dhe ku vlerësimi pozitiv është gjithashtu i përafërt, me rreth 18%.

Vlerësimet pjesërisht pozitiv dhe pjesërisht negativ kanë vetëm tre pikë diferencë, përkatësisht 13% dhe 16%, ndërkohë që qytetarët e anketuar nuk kanë pasur hezitim në dhënien e përgjigjes dhe përcaktimin e një vlerësimi mbi efikasitetin e punës së bashkisë në këto sektorë.




Në analizën krahasuese të pesë bashkive të qarkut, rezulton se kuotat më të larta pozitive janë dhënë nga qytetarët e bashkisë Vorë me 41%, në diferencë të madhe me bashkitë e tjera. Kuota e dytë më e lartë pozitive në shërbimet e gjelbërimit dhe të ndriçimit është shënuar në Tiranën urbane me 18%, 8% më shumë sesa në Tiranën rurale, si dhe në Rrogozhinë me 15%.

Në bashkinë Kavajë vlerësimi pozitiv arrin kuotat 10% dhe në Kamëz shënohet rezultati më i vogël i vlerësimit pozitiv, vetëm 7%. Në vlerësimet negative mbi shërbimet e bashkisë në këto dy problematika lokale, rekord shënohet në bashkinë Kamëz me 47%, ndjekur nga Rrogozhina me 39%, Kavaja 34%, etj, kurse shifrat më të ulta negative janë shënuar në Vorë me 3.4% dhe në Tiranën urbane me 12%.

GJELBËRIMI DHE NDRIÇIMI						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pozitivisht	18,2%	10%	10,9%	15,1%	7%	41,5%
Pjesërisht pozitivisht	19,5%	12,5%	6,7%	12,6%	4%	15%
Nivel mesatar	35,9%	26,7%	24,4%	22,7%	14%	28,6%
Pjesërisht negativisht	13,2%	16,7%	26,9%	9,2%	23%	11,6%
Negativisht	12,7%	34,2%	30,3%	39,5%	47%	3,4%
Pa përgjigje	0,5%	0	0,8%	0,8%	5%	0

6.7. VLERËSIMI MBI SHËRBIMIN RRUGË DHE TROTUARE OFRUAR NGA BASHKITË

Në funksionin e bashkisë në drejtim të shërbimeve të mirëmbajtjes së rrugëve dhe të trotuareve, një problematikë që bën pjesë në prioritetet e qytetarëve edhe për mandatin e ardhshëm lokal, në nivel qarku rezulton se ka baraspeshë midis vlerësimeve “pozitivisht”, “nivel mesatar” dhe “negativisht”. Diferenca në këto përcaktime është nga 0% në 4%, - një tregues balance në vlerësime. Edhe në kategorizimin “pjesërisht pozitivisht” dhe “pjesërisht negativisht” diferencat janë të vogla, vetëm 2%. Në tërësi tendenca është kritike, por në raport me disa vlerësime të tjera të renditura më lart, notat kritike nuk janë të thella.



Në krahasimin e rezultateve për secilën bashki më vete, rezultoi se vlerësimet më të larta pozitive për punën e bashkive për rrugët dhe trotuaret janë dhënë në bashkinë Vorë me 46%, me diferencë të thellë nga vlerësimi i dytë më i mirë, ai i bashkisë Tiranë, zona urbane, me 20%.

Analiza e Tiranës rurale dhe Rrogozhinës tregon se ka vlerësim të njëjtë pozitiv, 13% me diferencë minimale me Kavajën 12% dhe po ashtu me Kamzën 11%. Në vlerësimin negativ përqindja më e lartë është dhënë nga qytetarët e Rrogozhinës me 39%, ndjekur nga Kavaja dhe Tirana rurale me 35%, Kamza me 29%, dhe në fund ndodhet Tirana urbane me 14% dhe Vora me vetëm 6.8%.

RRUGËT DHE TROTUARET						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pozitivisht	20,5%	12,5%	13,4%	13,4%	11%	46,3%
Pjesërisht pozitivisht	20%	13,3%	10,1%	9,2%	9%	15%
Nivel mesatar	29,5%	22,5%	21%	24,4%	27%	17,7%
Pjesërisht negativisht	15,5%	16,7%	19,3%	10,1%	21%	13,6%
Negativisht	14,1%	35%	35,3%	39,5%	29%	6,8%
Pa përgjigje	0,5%	0	0,8%	3,4%	3%	0,7%


7. VLERËSIMI MBI KËSHILLTARËT DHE KAPACITETET PËRFAQËSUESE TË TYRE

Pjesë e anketimit u bënë edhe disa pyetje që lidhen me vlerësimet e qytetarëve mbi këshilltarët, mbi cilësinë e edukimit dhe përfaqësimit të tyre, si dhe mbi praktikën e sugjeruara për përmirësimin e komunikimit midis këshilltarëve dhe qytetarëve në të ardhmen.

7.1. RËNDËSIA E KONTAKTIT ME QYTETARËT

Pjesë e rëndësishme e rritjes së nivelit të konsultimit publik, të llogaridhënies dhe të transparencës në raportet e këshilltarëve lokalë me qytetarët, janë përdorimi i mekanizmave të ndryshëm të komunikimit në dispozicion. Qytetarët u pyetën për disa nga këto mekanizma, nëse ato janë të rëndësishme për të krijuar një lidhje më të fortë të këshilltarëve me qytetarët votues dhe nëse ato përbëjnë ndryshim pozitiv për mirëqeverisjen lokale.

Qytetarët u pyetën se në vlerësimin e detyrimeve të këshilltarëve bashkiakë sa e vlerësoni komponentin e nevojës për kontakt me qytetarët e zonës (përdorimi i formave të ndryshme të komunikimit). Në përgjigjet e tyre qytetarët në 33% ishin me vlerësim negativ mbi efikasitetin e kësaj forme komunikimi dhe vetëm 8% mendojnë se është një formë efikase dhe pozitive. Numri i qytetarëve që është skeptik është shumë më i lartë sesa i atyre që janë optimistë. Konkretisht, në vlerësimin kritik e negativ të faktorit të kontaktit aktiv me qytetarët e zonës, është në raportet 53% me rreth 17%.




Në vlerësimin në secilën bashki mbi rëndësinë e kontaktit të këshilltarëve me qytetarët e zonës, përmes formave të ndryshme të komunikimit, vlerësimi më i lartë pozitiv është shënuar në Vorë 17%, e vetmja bashki mbi 10%. Bashkitë e tjera luhahen midis 4% në Kavajë dhe 6% në Tiranë, Kamzës e diçka më shumë në Rrogozhinë. Në vlerësimin negativ për impaktin e komunizmit direkt me qytetarët, përqindja më e lartë është shënuar në Kamzë 57% dhe më pas me kuota të njëjta 44% janë Rrogozhina dhe Tirana rurale. Me një diferencë minimale është renditja edhe e Kavajës, 40%, kurse Tirana urbane ka përqindje pesë herë më të lartë pozitive sesa negative. Në fund të listës për përgjigjet negative ndodhet Vora, me vetëm 7.5%, mbi tre herë më pak sesa opinioni negativ i qytetarëve të Tiranës dhe mbi 6 herë më pak sesa opinioni negativ i banorëve të Rrogozhinës apo Tiranës rurale.

KONTAKTI ME QYTETARËT (PËRDORIMI I FORMAVE TË NDRYSHME TË KOMUNIKIMIT)						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pozitivisht	5,9%	4,2%	6,7%	7,6%	6%	17,7%
Pjesërisht pozitivisht	10,5%	2,5%	6,7%	8,4%	2%	19%
Nivel mesatar	35,5%	25,8%	18,5%	21,8%	16%	29,9%
Pjesërisht negativisht	18,2%	26,7%	17,6%	14,3%	15%	24,5%
Negativisht	25%	40%	44,5%	44,5%	57%	7,5%
Pa përgjigje	5%	0,8%	5,9%	3,4%	4%	1,4%

7.2. BILANCI I NISMAVE PËR PROBLEMATIKAT QYTETARE

Lidhur me bilancin e këshilltarëve në funksionin për marrjen e nismave të ndryshme ligjore, politike ose administrative për problematika e çështje që lidhen me qytetarët, të anketuarit e qarkut Tiranë shprehën qëndrime dukshëm kritike. Sipas të dhënave, një e treta e të pyeturve kishte mendim dukshëm negativ për bilancin e këshilltarëve në ushtrimin e kësaj përgjegjësie, dhe në total, 56% kishin në tërësi vlerësim negativ. Mendim pozitiv shprehën vetëm 5% dhe bashkë me grupin me mendim të pjesëshëm pozitiv, vlerësimi nuk kalon 15%, me një diferencë gati 40% me mendimin negativ.



Duke analizuar perceptimet qytetarë në secilën bashki më vete lidhur me bilancin e punës së këshilltarëve në ndërmarrjen e nismave për çështje e problematika prioritare të komunitetit, rezultoi se vlerësimi më i lartë pozitiv është 11% dhe gjendet tek banorët e bashkisë Vorë.

Në të gjitha njësitë e tjera bashkiake vlerësimi pozitiv nuk kalon 6%, ku Tirana, Kamza e Kavaja janë në nivelin e 3% mendim pozitiv. Në vlerësimin negativ rekord mbajnë opinionet e qytetarëve në bashkinë


Rrogozhinë me 51%, ndjekur nga Kamza dhe Kavaja me nga 44%. Banorët e zonave rurale në Tiranë kanë përqindje të lartë të vlerësimit negativ, 48%, ndaj 28% që kanë banorët e Tiranës urbane.

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pozitivisht	3,2%	3,3%	4,2%	5,9%	3%	11,6%
Pjesërisht pozitivisht	6,8%	5%	1,7%	5,9%	3%	21,1%
Nivel mesatar	25,9%	15,8%	18,5%	14,3%	12%	25,9%
Pjesërisht negativisht	21,8%	28,3%	15,1%	12,6%	28%	24,5%
Negativisht	28,6%	43,3%	48,7%	51,3%	44%	11,6%
Pa përgjigje	13,6%	4,2%	11,8%	10,1%	10%	5,4%

7.3. VLERËSIMI PËR NIVELIN E PËRGATITJES SË KËSHILLTARËVE

Qytetarët u pyetën në lidhje me perceptimin që ata kanë mbi nivelin e edukimit dhe formimit profesional të këshilltarëve në bashkinë ku ata jetojnë. Në nivel qarku, shumica e të pyeturve kishte qëndrime neutrale në vlerësim, me 31% vlerësim mesatar, 21% negativ dhe 9% pozitiv. Rreth 12% nuk ishin në gjendje të jepnin një përgjigje të qartë sipas alternativave në anketim.

Në tërësi kjo renditje tregon se megjithëse qytetarët janë skeptikë për nivelin e kualifikimit të këshilltarëve edhe për shkak se sic u pohua më lart, ata kanë nivel minimal njohje me këshilltarët dhe natyrshëm, edhe nivel minimal njohje me formimin e tyre profesional.




Në nivel bashkish rezulton se qytetarët me vlerësimin më të lartë për formimin profesional të këshilltarëve janë ata të bashkisë Vorë, me 27%, rreth 9 herë më shumë sesa vlerësimi që kanë dhënë

qytetarët e Tiranës urbane. Vlerësimi pozitiv në bashkitë e tjera, përfshirë edhe Tiranën rurale është në kuota të njëjta, 5%-6%. Në vlerësimet negative dominuese janë përcaktimet në rastin e Rrogozhinës me 47% vlerësim negativ për nivelin e edukimit të këshilltarëve, ndjekur nga Tirana urbane me 25%, Kavaja me rreth 20%, Tirana rurale 21%, Kamza me 17%. Qytetarët e bashkisë Vlorë kanë vlerësimin më të ulët negativ ndaj formimit të këshilltarëve të tyre, vetëm 0.7%.

NIVELI I EDUKIMIT / FORMIMIT TË TYRE						
PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pozitivisht	3,6%	4,2%	5%	7,6%	5%	27,9%
Pjesërisht pozitivisht	10%	15%	5,9%	9,2%	8%	18,4%
Nivel mesatar	26,8%	35%	34,5%	22,7%	42%	34%
Pjesërisht negativisht	16,8%	17,5%	15,1%	5,9%	17%	14,3%
Negativisht	25,5%	19,2%	21%	47,9%	17%	0,7%
Pa përgjigje	17,3%	9,2%	18,5%	6,7%	11%	4,8%

7.4. BILANCI I MBAJTJES SË PREMTIMEVE ELEKTORALE

Në fushata elektorale të gjithë flasin bilancin e premtimeve të vjetra dhe premtimet e reja. Qytetarët u pyetën nëse kanë një vlerësim mbi bilancin e këshilltarëve në raport me mbajtjen e premtimeve të dhëna prej tyre në fushatën elektorale të vitit 2015. Bilanci është dukshëm kritik: rreth 45% e qytetarëve janë të pakënaqur me mbajtjen e premtimeve dhe e vlerësojnë negativisht punën e këshilltarëve në raport me premtimet e dhëna. Vlerësimi pozitiv është mbi 6 herë më i vogël se sa kuota negative, vetëm 7% e qytetarëve. Në total vlerësimet pozitive janë 15% nga 61% vlerësime negative, ose në pesë qytetarë vetëm njëri mendon se këshilltarët kanë mbajtur premtimet e tyre.




Krahasimi i të dhënave të anketimit për secilën bashki jep gjithashtu të dhëna interesante. Banorët e bashkive Vorë janë konsekuentë në vlerësimet pozitive për këshilltarët e tyre lokalë, me 18% vlerësim pozitiv dhe po kaq vlerësim negativ. Në bashki si Tirana urbane raportet janë përkatësisht 5% me 36%, në Kavajë 3% me 63%, në Tiranën rurale 0.8% me 58.8%, në Rrogozhinë 8% me 59% dhe në Kamëz 4% me 52%. Diferencat e mëdha midis vlerësimit pozitiv dhe negativ në këto bashki janë tregues i perceptimit dominues se këshilltarët nuk kanë mbajtur premtimet e dhëna në zgjedhjet lokale të vitit 2015.

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pozitivisht	5,5%	3,3%	0,8%	9,2%	4%	18,4%
Pjesërisht pozitivisht	10,5%	4,2%	4,2%	4,2%	1%	17%
Nivel mesatar	25,9%	12,5%	13,4%	13,4%	21%	27,9%
Pjesërisht negativisht	18,2%	15,8%	20,2%	6,7%	17%	14,3%
Negativisht	36,4%	63,3%	58,8%	59,7%	52%	18,4%
Pa përgjigje	3,6%	0,8%	2,5%	6,7%	5%	4,1%

7.5. QËNDRIMI BESNIK NDAJ PARTISË VS BESNIKËRIA NDAJ QYTETARËVE

Këshilltarët janë zgjedhur me sistemin e listave të mbyllura, ku zgjedhësi voton partinë dhe partia bën renditjen paraprake të këshilltarëve. Për rrjedhojë, një prej kritikave kryesore ndaj sistemit të zgjedhjes së tyre lidhet me lidhjet e forta të këshilltarëve me partinë politike dhe lidhjet e dobëta me elektoratin.

Për të testuar këtë marrëdhënieve ISP pyeti qytetarët mbi perceptimin e tyre mbi atë nëse këshilltarët demonstrojnë qëndrim besnik ndaj partisë më tepër se qëndrim besnik ndaj qytetarëve. Bazuar në përgjigjen e dhënë në nivel qarku, rezultoi se 47% e të pyeturve e konsiderojnë negativ vlerësimin se këshilltarët janë më shumë besnikë të partisë sesa të zgjedhësve, dhe rreth 20% e konsiderojnë atë një raport pozitiv. Në tërësi vlerësimi pozitiv arrin në 21-22% ndaj 58% në dy vlerësimet negative.



Analiza për secilën bashki lidhur me vlerësimin nëse është pozitive apo negative prioriteti që këshilltarët i japin besnikërisë ndaj partisë në raport me besnikërinë ndaj elektoratit zgjedhës, dha perceptime të ndryshme në bashkitë e qarkut. Konkretisht, vlerësim të lartë pozitiv dhanë banorët e Rrogozhinës, me 24%, të Kamzës 22% dhe më pas të Tiranës urbane me 12%, ndërkohë që kuotat pozitive në Kavajë e Vorë ishin pak më shumë se 4%.

Në cilësimin e kësaj dukurie si zhvillim negativ, vlerësimin më të lartë e dhanë po qytetarët e Rrogozhinës me 54%, pothuajse njëjtë me banorët e Tiranës urbane dhe rurale (53%) dhe me diferencë minimale me Kavajën (50%). Banorët e Kamzës dhe të Vorës patën të njëjtën kuotë vlerësimi negativ, 32%.

QËNDRIMI BESNIK NDAJ PARTISË MË TEPËR SE BESNIKËRIA NDAJ QYTETARËVE

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Pozitivisht	12,3%	4,2%	9,2%	24,4%	22%	4,8%
Pjesërisht pozitivisht	3,2%	6,7%	5%	5,9%	17%	13,6%
Nivel mesatar	13,6%	23,3%	16,8%	5,9%	13%	22,4%
Pjesërisht negativisht	10,5%	14,2%	7,6%	1,7%	9%	21,1%
Negativisht	53,6%	50,8%	53,8%	54,6%	32%	32,7%
Pa përgjigje	6,8%	0,8%	7,6%	7,6%	7%	5,4%


8. PËRCEPTIME QYTETARE PARA-ZGJEDHORE 2019

Duke matur perceptimin qytetar mbi rrugëzgjdhjet dhe përmirësimet e sistemit përfaqësues dhe llogaridhënës të të zgjedhurve vendorë, ISP adresoi edhe pyetjen lidhur me preferencën për sistemin e zgjedhjes së këshilltarëve. Aktualisht Shqipëria vijon të jetë besnikë e formulës së vitit 1992, e konfirmuar edhe me Kushtetutën 1998 dhe ndryshimet kushtetuese 2008, për sistem të zgjedhjes së këshilltarëve me lista të mbyllura të partive politike konkurruese.

8.1. SISTEMI ELEKTORAL PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLTARËVE

Në vlerësimin në nivel qarku, qytetarët u përgjigjen se nëse do të kishin mundësi në zgjedhjet e vitit 2019 për organet e qeverisjes vendore në masën 87% e tyre do të preferonin të zgjidhnin këshilltarët mbi bazën e listave të hapura brenda listave të partive politike.

Përmes kësaj zgjedhjeve ata shprehen se duan të kenë lidhje m individin e zgjedhur dhe për pasojë, zgjedhja direkt (me listë të hapur) mundëson më shumë lidhje, përfaqësim dhe llogaridhënie. Vetëm 5% e të pyeturve ishin në favor të ruajtjes së sistemit aktual të zgjedhjes me listë të mbyllur, kurse pjesa prej 8% ishte e pavendosur për sistemin më të mirë të zgjedhjes.



Në anketimin e zhvilluar në pesë bashkitë e qarkut Tiranë, rezultoi se mbështetja për ndryshimin e sistemit të zgjedhjes së këshilltarëve, duke kaluar nga sistemi pasiv me zgjedhje me listë të mbyllur përmes listave të partive politike tek sistemi me listë të hapur konkurruese brenda listave të partive politike, - është më e lartë në bashkinë Kavajë (91%), Tiranën rurale (90%) dhe Kamëz (89%) dhe më e vogël në Tiranën urbane (85%), Rrogozhinë (80%) dhe sidomos në Vorë (83%).

Numri i qytetarëve të pavendosur për preferencën ndaj sistemit të zgjedhjes ishte shumë i lartë në Rrogozhinë (15%), më pas në Vorë (9.5%) e Tiranë (8.6%), kurse më të vendosur në preferenca duhen banorët në Kamëz me të pavendosur 3% dhe në Kavajë 6%.


**NËSE DO TË KISHIT MUNDËSINË TË VENDOSNIT, NË ZGJEDHJET E ARDHME LOKALE
JU DO TË PREFERONIT QË KËSHILLTARËT BASHKIAK:**

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Zgjedhje direkt (listë të hapur)	85,5%	91,7%	90,8%	80,7%	89%	83%
Zgjedhje indirekt (listë të mbyllur)	5,9%	3,3%	2,5%	4,2%	8%	7,5%
Pa përgjigje	8,6%	5%	6,7%	15,1%	3%	9,5%

8.2. PREMTIMET PERSONALE TË KËSHILLTARËVE NDAJ QYTETARËVE

Qytetarët u pyetën edhe për raportet e tyre personale me këshilltarët bashkiakë, - nëse këta të fundit u kanë dhënë një premtim nominal më 2015 dhe nëse e kanë mbajtur këtë premtim. Në përgjigjen e dhënë në nivel qarku, rezultoi se më shumë se gjysma e qytetarëve deklarohen se këshilltarët nuk i kanë mbajtur premtimet e dhëna edhe në raport personal, 14% shprehen se i kanë mbajtur premtimet, vetëm 3.5% vlerësojnë se nuk kanë marrë asnjë premtim më 2015 e për pasojë nuk mund të kërkojnë llogari 3-4 vite më pas, kurse 26% janë të pavendosur, në kuptimin se premtimet i kanë parë sa personale aq edhe në emër të komunitetit lokal, ndaj e kanë të vështirë ta masin bilancin e mbajtjes së premtimit.

**NË RASTET QË KËSHILLTARËT BASHKIAK JU KANË PREMTUAR
JUVE DIÇKA KONKRETE MË 2015**



Në nivel bashkish, analiza e të dhënave tregon se ekzistojnë përsëri hendek i madh midis njësive të ndryshme, lidhur me rastet e kontakteve dhe premtimeve personale të këshilltarëve ndaj zgjedhësve të përfshirë në anketim. Konkretisht, me vlerësime pozitive për këshilltarët dhe mbajtjen e premtimeve shprehen banorët e Vorës (34%). Me diferencë të mëdha prej tyre përqindje pozitive kanë edhe banorët e Tiranës urbane me 12% dhe ata të Rrogozhinës me 13%.


Në vlerësimet negative dhe argumentin se këshilltarët nuk i kanë mbajtur premtimet e dhëna personalisht tek personat e anketuar, kuotat janë të larta, nga 30% në Vorë dhe 40% në Tiranën urbane, në 62% në Kavajë dhe 70% në Kamëz. Në vlerësimet se nuk kanë dhënë premtime, kuotat janë minimale dhe vetë diferencat midis bashkive janë minimale, përkatësisht midis 3% dhe 5%. Numri më i madh i personave pa përgjigje të qartë në ndarjet e tabelës janë në Tiranë (35%), në Vorë (28% dhe në zonat e tjera midis 13% dhe 21%.

RASTET QË KËSHILLTARËT BASHKIAK JU KANË PREMTUAR JUVE DIÇKA KONKRETE MË 2015 PËRGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Kanë mbajtur premtimin	12,2%	7,5%	5%	13,4%	9%	34%
Nuk e kanë mbajtur premtimin	45%	62,5%	57,1%	56,3%	70%	30,6%
Pjesërisht e kanë mbajtur	2%	4%	7,8%	5,3%	5%	4%
Nuk kam marrë premtime	5%	4,4%	3%	5%	3%	3%
Pa përgjigje	35,8%	21,6%	27,1%	20%	13%	28,4%

8.3. VLERËSIMI PËR RI-ZGJEDHJEN E KËSHILLTAVE BASHKIAKË

Pas vlerësimit të të gjithë treguesve dhe komponentëve të matjes së efikasitetit të këshilltarëve bashkiak, bilancit të punës dhe raporteve të përfaqësimit, qytetarët u pyetën se nëse do të kishte sot zgjedhje të reja lokale ose nëse votojnë në zgjedhjet e vitit 2019 a do të preferonin rizgjedhjen e anëtarëve aktualë të këshillave bashkiakë.

Në nivel qarku, përgjigjia ishte në shumicë (51%) në favor të ndryshimeve drastike në përbërjen e listës së këshilltarëve aktualë, vetëm një e katërta ishte për rizgjedhje të tyre dhe 21% shprehen të pavendosur. Është interesant fakti se numri i personave që nuk duan të japin përgjigje në këtë pikë është relativisht i vogël, një tregues se qytetarët kanë interes tek këshilli bashkiak dhe janë sensin e përgjegjësishë për një rritje standardi në përfaqësimin dhe qeverisjen lokale në komunitetin e bashkinë e tyre.



Në analizën për secilën bashki më vehte nëse duhet rizgjedhur i njëjti këshill bashkiak edhe në zgjedhjet e radhës lokale, rezulton se perceptimet ndryshojnë midis dy kategori bashkish: ato që kanë vlerësim në tërësi pozitiv dhe mendojnë se edhe mund të ketë rizgjedhje. Për shembull, në Vorë rreth 40% janë për rizgjedhje, në Rrogozhinë dhe Tiranën urbane janë gjithashtu rreth 30% për rizgjedhje. Ndryshe paraqitet situata në tri njësitë e tjera në anketim, në Kavajë, Kamëz dhe Tiranën rurale, ku përqindja e qytetarëve që pranojnë rizgjedhjen e këshillit aktual bashkiak është minimale, vetëm 15% deri 17%.

Në shprehjen e refuzimit të qartë për rizgjedhjen e këshillit aktual bashkiak përqindjet më të larta i kanë banorët Kavajës me 61% dhe Kamzës 58%, ndjekur nga Rrogozhina dhe Tirana rurale me nga 53%-55% si dhe në fund, Tirana urbane dhe Vora me nga 45% dhe 41%. Në kategorinë e të pavendosurve numri më i madh i opinionëve shprehet tek banorët e Tiranës (rurale dhe urbane) me përkatësisht 26% dhe 24%, duke vijuar me mesatare thujtse të njëjtë 20% në Kamëz, Kavajë e Vorë dhe me kuotë 11% në Rrogozhinë.

BAZUAR NË PERFORMANCËN E DERITANISHME, A DUHET TË RIZGJIDHET KËSHILLI BASHKIAK PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
PO, DUHET RIZGJEDHUR	29,5%	15%	17,7%	30,3%	15%	39,5%
JO, NUK DUHET RIZGJEDHUR	45%	61,7%	53,8%	55,5%	58%	41,5%
NUK JAM I VENDOSUR	24,5%	20,8%	26,1%	11,8%	21%	19%
PA PERGJIGJE	0,9%	2,5%	2,5%	2,5%	6%	0

8.4. VLERËSIMI I PAMUNDUR PËR 3 KËSHILLTARË POZITIVË / NEGATIVË

Ne i pyetëm qytetarët për të cituar të paktën tre këshilltarë me vlerësim pozitiv dhe tre këshilltarë me vlerësim negativ në bashkinë e tyre. Nga përgjigjet e dhëna pjesa më e madhe e tyre (rreth 76%) nuk ishin në gjendje të njihnin 6 këshilltarë në mënyrë që të kishin mundësi vlerësimi pozitiv e negativ, madje pjesa më e madhe e kësaj shifre njihje shumë më pak sesa tre këshilltarë në total. Për pasojë, përgjigjet e tjera të mbledhura nga anketimi treguan se ka një perceptim kryesisht partiak dhe lokal për këshilltarët. Për këshilltarë me vlerësim pozitiv u dhanë emra që kishin shpjegim me afrinë me bindjet e tyre politike ose me përkatësinë në lagje, fis, njohje personale, etj, kurse për këshilltarët me vlerësim negativ kryesisht u cituan emra që i përkasin partive rivale politike ose që i kanë njohur e vlerësuar përmes lajmeve të dëgjura në media të ndryshme.

Në përgjigjet e ndryshme, pati raste kur u cituan këshilltarë që realisht i përkasin bashkive jashtë zonës ku bëhej anketimi, për shkak të perceptimit mediatik që qytetarët kanë krijuar për emrat dhe mosnjohjen e saktë të listës së këshilltarëve. Në të paktën 50 raste u cilësuan këshilltarë të mirë emra deputetësh që kanë qenë këshilltarë më parë, dhe pas sqarimit se ata nuk janë këshilltarë, të pyeturit, duket se mbeteshin të habitur pasi nuk kishin dijeni mbi zëvendësimin e tyre. Gjithashtu, pati raste jo të pakta, (sidomos në Rrogozhinë, Kavajë, Vorë, Kamëz) ku në listën e këshilltarëve pozitiv ose negativ citohej emri i kryetarit të bashkisë dhe vetëm pasi u thuhej se personi nuk është këshilltar, por kryetar, atëherë ata mendonin një përgjigje tjetër. Kjo është një e dhënë simbolike që tregon nivelin problematik të njohjes së këshilltarëve nga komuniteti ku janë zgjedhur dhe të vetë interesit të qytetarëve për tu interesuar e njohur më mirë vendimmarrësit në bashkinë e tyre.


Në këto rrethana ISP e vlerësoi të pamundur të bëjë një listim të tre këshilltarëve më të suksesshëm dhe të tre këshilltarëve më pak të suksesshëm në nivel qarku dhe për secilën bashki. Edhe në renditjen

numerike, kuota më e lartë për një këshilltar të suksesshëm nuk kaloi 1,7% të të gjitha vlerësimeve në nivel qarku, (V.Tana e L.Vrana në Vorë; V.Kaja në Rrogozhinë; A.Dalipi, I.Vejsiu, L.Olli, T.Mema, J.Kola, M.Bogdani dhe A.Nanaj në Tiranë; M.Katrioshi dhe N.Ajdini në Kavajë; M.Lusha, B.Bajraktari, R.Perleka në Kamëz,) etj. Dy prej këtyre emrave (Tiranë) bëjnë pjesë edhe tek vlerësimet që janë dhënë për këshilltarët më të pasuksesshëm.

Qytetarët u pyetën nëse kanë në telefonin e tyre një numër kontakti telefoni të ndonjë prej këshilltarëve të bashkisë ku ata jetojnë. Sic pritej, shumica absolute e qytetarëve (77%) deklaruan se nuk kanë numër kontakti me asnjërin prej këshilltarëve dhe vetëm 6% pranuan se kanë numër kontakti.

Qytetarët që deklaruan se kanë një numër kontakti telefonik me këshilltarët bashkiakë në zonën ku ata banojnë, u pyetën për arsyet e mundshme që e kanë këtë kontakt. Midis alternativave të shumta, përgjigjia më e shpeshtë kishte të bënte me nevojën për “komunikim për problematikat”, ndjekur nga motivi “kam miqësi, jemi shokë, njohje personale”, “për arsye familjare”, për “arsye pune”, “e kam në lagje”, etj.

A KENI JU NË TELEFONIN TUAJ NJË NUMËR TELEFONI TË NDONJË KËSHILLTARI BASHKIAK?



Në vlerësimin sipas bashkive, personat që deklaruan se kanë numër kontakti me këshilltarët i përkisnin, 12% në Vorë, si dhe 3% deri 6% në bashkitë e tjera. Në deklarimin e atyre që nuk kanë numër kontakti (duke hequr personat që nuk dhanë përgjigje), rezultoi se përqindjen më të lartë të qytetarëve pa kontakt telefonik me këshilltarët janë banorët e Kamzës me 96%, të Kavajës 87%, të Tiranës rurale 78%, si dhe Tirana urbane e Rrogozhina me nga rreth 70%.

A KENI JU NË TELEFONIN TUAJ NJË NUMËR TELEFONI TË NDONJË KËSHILLTARI BASHKIAK?

PERGJIGJET	T-URBANE	KAVAJE	T-RURALE	RROGOZHINE	KAMEZ	VORE
Po, kam	5,9%	3,3%	4,2%	5%	4%	12,2%
Jo, nuk kam	70,5%	87,5%	78,2%	71,4%	96%	70,7%
Pa përgjigje	23,6%	9,2%	17,6%	23,5%	0	17%